



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 24/67

Datë: 09.03.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Ekspertet Gjyqësorë.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTARSTVO PRAVDE / MINISTRY OF JUSTICE

KONCEPT DOKUMENTI
PËR
EKSPERTËT GJYQËSORË

18 shkurt, 2021

Përmbledhje e koncept dokumentit	3
Hyrje	5
1.1. HYRJE NË PËRKUFIZIMIN E PROBLEMIT	7
1.2. ZBATIMI I ACQUIS SË BE-SË DHE STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE	9
1.2.1 Udhëzuesi mbi Praktikat e Mira në Ekspertiza Gjyqësore Civile në Bashkimin Evropian	10
1.2.2. Udhëzuesi për rolin e ekspertëve të caktuar nga gjykata në procedurat gjyqësore të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës	11
1.2.3 Raporti i CEPEJ mbi Sistemet gjyqësore evropiane - Botimi 2014: efikasiteti dhe cilësia e drejtësisë	15
1.3 Shtetet në rajon	16
1.4 Korniza e politikave dhe e legjislacionit të Kosovës	27
1.5 Elaborimi i problemit kryesor	32
Kapitulli 3: Opcionet	40
Kapitulli 3.1: Opcioni asnjë ndryshim	40
Kapitulli 3.2: Opsioni për ndryshimin dhe plotësimin e kornizës ekzistuese ligjore ..	40
Kapitulli 3.3: Nxjerrja e një ligji të ri për emërimin e ekspertëve gjyqësorë.	43
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme	47
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave.....	49
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi	49
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve	51
Kapitulli 6.1: Plani i zbatimit për opsionet e ndryshme.....	52
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm	54
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin	54
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik.....	55
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore	58
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore	62
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore.....	65

Përmbledhje e koncept dokumentit

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept Dokumenti për Ekspertët (ekspertizat) Gjyqësorë
Ministria bartëse	Ministria e Drejtësisë-Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP)
Personi kontaktues	Selvi Elezaj-Brahimaj, Udhëheqëse e Divizionit për Koordinim të Politikave, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP), Ministria e Drejtësisë
Plani Strategjik Operacional	Koncept Dokumenti është i paraparë në listën e koncept dokumenteve për vitin 2020-21
Prioriteti strategjik	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025.

Vendimi	
Çështja kryesore	Procedura për emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve gjyqësorë si dhe të drejtat dhe detyrimet e personave që kryejnë ekspertizë.
Përmbledhje e konsultimeve	Procesi i konsultimeve për Koncept Dokument u zhvillua në periudhën nga 14 janari 2021 deri më maj 2021. Komentet e pranuar gjatë kësaj faze të konsultimeve janë shqyrtuar nga ana e grupit punues dhe ato komente që janë konsideruar relevante janë inkuadruar në Koncept Dokument. Theksohet se nuk ka pasur ndonjë mosmarrëveshje të theksuar sa i përket substancës së Koncept Dokumentit me ministritë e tjera të linjës dhe akterët tjerë relevant. Konsultimi publik është realizuar me shkrim përmes platformës online për konsultimet publike dhe përmes e-mailit tek organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile. Konsultimi publik është realizuar sipas Rregullores për standardet minimale të konsultimeve publike nga data 28 dhjetor 2021 deri më 20 janar 2022, ku kemi pranuar rreth 20 komente nga katër kontribuues. Për më tepër, kjo faze do të përshkruhet në Raportin e Konsultimit.
Opsioni i propozuar	Opsioni 3 – Ndryshimi i kornizës ligjore përmes miratimit të ligjit të veçantë për vendosjen e procedurës për emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve gjyqësorë si dhe të drejtat dhe detyrimet e personave që kryejnë ekspertizë.

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Zbatohet në kuadër të kufinjëve aktual buxhetorë

Ndikimet ekonomike	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori.
Ndikimet shoqërore	Nuk ka ndikime të pritshme të theksuara në këtë kategori.
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori.
Ndikimet ndër-sektorale	Ndikimet e ndërlidhura më të rëndësishme kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut, përkatësisht të drejtat pronësore dhe lirinë në të bërit biznes, të drejtë në mbrojtje efektive gjyqësore dhe qasje në të dhëna.
Ngarkesat administrative për kompanitë	Nuk vlen.
Testi i NVM-ve	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta relevante.

Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	Hartimi i Projektligjit që rregullon procedurën për emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve gjyqësorë si dhe të drejtat dhe detyrimet e personave që kryejnë ekspertizë.
Afatmesëm	1. Nxjerrja e akteve nënligjore 2. Zhvillimi i procedurës për emërimin e ekspertëve gjyqësorë 3. Publikimi i regjistrit të ekspertëve gjyqësorë

Hyrje¹

Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti për Ekspertët (Ekspertizat) Gjyqësorë
Ministria bartëse	Ministria e Drejtësisë, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP)
Personi kontaktues	Selvije Elezaj-Brahimaj, Udhëheqëse e Divizionit për Koordinim të Politikave, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP), Ministria e Drejtësisë
PSO	Koncept Dokumenti është i paraparë në listën e Koncept Dokumenteve të vitit 2021
Prioriteti strategjik	- Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative - Reforma në drejtësi penale nëpërmjet hartimit të politikave publike (legjislacionit dhe dokumenteve të politikave)
Objektiva Operacionale	
Grupi punues	- Selvije Elezaj-Brahimaj, Kryesuese, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave - Ardian Mehmeti, Zëvendës Kryesues, Departamenti Ligjor - Besim Kelmendi, Këshilli Prokurorial i Kosovës - Vaton Dërguti, Gjykata e Apelit - Arsim Gërzhaliu, Instituti i Mjekësisë Ligjore - Shpend Haxhibeqiri, Instituti i Psikiatriisë Forenzike - Pleurat Sejdiu, Oda e mjekëve të Kosovës - Naim Krasniqi, Avokatura Shtetërore - Lavderim Bullatovci, Agjencia e Kosovës për Forenzikë - Agron Thaqi, Departamenti i Tatimit në Pronë - Shqipe Cakolli, Divizioni për Buxhet dhe Financa - Egzon Osmanaj, Divizioni për Koordinim të Politikave (DIEKP) - Saranda Salihu, Zyrtarë nga Departamenti i Komunikimit Publik - Florentina Beqiraj- Njësia për të drejtat e njeriut - Alberita Hyseni-Zyra Ligjore, ZKM - Gezim Bislimi- Analist i lartë i buxhetit - Shqiptar Ibra- Sekretariati Koordinues i Qeverisë

¹ Shprehjet të cilat përdoren në këtë dokument për personat fizik në njërin gjini, nënkuptojnë shprehje të njëjta edhe në gjininë tjetër.

KAPITULLI 1: PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

1.1. HYRJE NË PËRKUFIZIMIN E PROBLEMIT

Ekspertiza gjyqësore është një veprimtari profesionale e cila përmes metodave shkencoro-teknike i ofron institucionit gjyqësor që ka kërkuar ekspertizën vërtetimin ose sqarimin e fakteve të rëndësishme për një çështje të caktuar. Si e tillë, ekspertiza mund të kryhet nga persona fizikë dhe juridikë që plotësojnë kushtet e parashikuara me ligj ose ndonjë akt tjetër juridik, si dhe nga organet shtetërore dhe institucionet shkencore e profesionale.

Që nga konsolidimi i sistemit gjyqësor në Kosovë në vitin 1999 e sidomos pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, licencimi² dhe angazhimi i ekspertëve gjyqësorë nuk është adresuar sa dhe si duhet. Si rrjedhojë, nuk janë ngritur asnjëherë mekanizmat për licencimin e ekspertëve gjyqësorë derisa veprimtaria e ekspertit gjyqësor vazhdon të ushtrohet nga individët të cilët nuk i janë nënshtruar ndonjëherë procesit të licencimit.

Sipas Ligjit për Gjykata (Nr. 05/L -032 dhe Nr. 06/L -054) të Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) është kompetent për të nxjerrë Rregulloren e cila trajton çështjen e ekspertëve gjyqësorë. Pavarësisht se KGjK-ja ka nxjerrë Rregulloren nr. 15/2015 për Emërimin e Eksperteve Gjyqësorë, e njëjta nuk ka arritur ta vë në funksion dhe ta zbatojë këtë Rregullore përveç pjesës së tarifave për pagesën e ekspertëve gjyqësorë. Lista apo regjistri i ekspertëve gjyqësorë që është në përdorim në shumicën e gjykatave dhe prokurorive me të cilat Ministria e Drejtësisë ka zhvilluar konsultimet në përgatitje të këtij koncept dokumenti daton nga periudha e UNMIK-ut³. Në të njëjtën kohë, shumica nga bashkëbiseduesit, përfaqësues të gjykatave dhe prokurorive, kanë pohuar se jo rrallë herë ftojnë ekspertë të cilët nuk janë fare në listë.

² Termi 'licencim' nënkupton vendimin përfundimtar në kuadër të procesit të formalizmit të funksionit të ekspertit gjyqësor pa ndonjë paragjykim në lidhje me termin certifikim/emërim që mund të përdoret në kuadër të procesit të mëtutjeshëm.

³ Në atë kohë, ligji në fuqi ka qenë Ligji mbi Gjykatat e Rregullta i KSA të Kosovës, i cili në nenin 108 përcakton se "Lista e personave juridikë shoqëror që bëjnë ekspertizë dhe ekspertë të përhershëm të gjykatave për të gjitha gjykatat publikohet nga Sekretariati Krahinor për Jurisprudencë dhe Administratë të Përgjithshme çdo vit në "Gazetën Zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës".

Çështja e angazhimit të ekspertëve gjyqësorë në ndarjen e drejtësisë në Kosovë është mjaft e shprehur si në çështjet civile po ashtu edhe në ato të natyrës penale. Ekspertët gjyqësorë kontribuojnë në ngritjen e efikasitetit gjyqësor duke u siguruar prokurorëve dhe gjyqtarëve përgjigje të qarta në çështje specifike për të cilat ata angazhohen.

Të dhënat nga regjistrat gjyqësorë apo nga Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Lëndëve (SMIL) nuk mundësojnë ekstraktimin e të dhënave në lidhje me numrin e ekspertëve gjyqësorë që angazhohen brenda një viti në çështje gjyqësore, megjithatë është një vlerësim i përgjithshëm se numri i çështjeve ku angazhohen ekspertët gjyqësorë është tejet i madh dhe si rrjedhojë rregullimi i kësaj çështje kërkon adresim imediat.

Megjithatë, nga informatat që janë përcjell nga institucionet publike që ofrojnë ekspertiza, rezulton se Agjencia e Kosovës për Forenzikë në vitin 2020 ka pasur 3441 ekspertiza, kurse deri me 31 tetor 2021 ka pasur 3774 ekspertiza.

Përgjatë procesit të përpilimit të këtij Koncept Dokumenti shumë bashkëbisedues kanë mirëpritur këtë nismë pasi që edhe ata si hisedarë të drejtpërdrejtë në këtë lëmi, kanë hasur në shumë çështje që kërkojnë shqyrtim të menjëhershëm. Një ndër këto, janë edhe disa parregullsi që janë hasur në procese gjyqësore e që janë potencuar nga shumica e bashkëbiseduesve. Sa për ilustrim, një përfaqësues i një institucioni⁴ ka potencuar se ata kanë gjetur se “i njëjti ekspert kur është i paditur shteti, p.sh. në rastet e shpronësimit të patundshmërive, jep vlerësim financiar për me një çmim shumë më të madh, derisa në rastet tjera kur i paditur është ndonjë person fizik apo juridik dhe parametrat e patundshmërisë janë po thuajse identike, jep vlerësim shume me të ulët”.

Të ngjashme përvoja janë ngritur edhe në lidhje me rastet kur cilësimi i lëndimit trupor konsiderohet si dëmtim i lehtë nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, derisa kur palët udhëzohen në kontest civil, ekspertiza në procedurë civile bën ri-cilësim të lëndimit trupor si lëndim i rëndë.⁵

Po ashtu, edhe organizata që merren me monitorime të proceseve gjyqësore, tregojnë se ekspertizat, sidomos në çështjet penale, nganjëherë nuk reflektojnë gjendjen reale, sidomos në rastet kur kemi të bëjmë me dëmin e shkaktuar nga të pandehurit, ku jo rrallë herë ndodh që në rastin e dëmit të shkaktuar me vepër penale të pretenduar ceket shuma e tërësishme e një kontratë prokurimi, edhe pse disa punë apo shërbime veçse janë realizuar nga po e njëjta kontratë. Kjo bën që disa vepra penale të ri-cilësohen edhe sipas vlerës së dëmit të shkaktuar.

⁴ Z. Agron Thaçi, Drejtor, Departamenti i Tatimit në Pronë, Ministria e Financave, 24 shkurt 2021.

⁵ Gjatë diskutimit janë vënë në pah edhe raste edhe pse atipike por që mund të ndodhin p.sh. nëse një pianist/e i lëndohen gishtërinjtë, ai në aspekt penal është lëndim i lehtë, por që në aspektin civil, ai dëmtim mund të rezultojë në dëme dhe pasoja të mëdha në karrierë.

Duke parë këto fenomene në raste gjyqësore, zhvillimi dhe rregullimi i fushës së ekspertizave gjyqësore rezulton të jetë hap i domosdoshëm nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Numri aktual i personave që ofrojnë ekspertiza gjyqësore është i panjohur pasi që gjykatat dhe prokuroritë, siç u cek më lartë, zyrtarisht ende shërbejnë me listën / regjistrin e ekspertëve gjyqësorë të përpiluar nga koha e UNMIK-ut, sikurse, jo rrallë herë gjyqtaret dhe prokurorët angazhojnë ekspertë gjyqësorë të cilët nuk janë në listë fare, madje as që kanë një vendim formal përmes të cilit u njihet cilësia e ekspertit.

Nga viti 2013 nuk është nxjerrë asnjë vendim për ekspertët gjyqësorë, që nga shfuqizimi i ligjit i cili ishte në fuqi deri në atë kohë (Ligji për Gjykatat e Rregullta të KSA të Kosovës, 1978). Në anën tjetër, Ligji i ri për Gjykatat dhe ai për Këshillin Gjyqësor të Kosovës nuk kishin të paraparë bazë ligjore për emërimin e ekspertëve gjyqësorë. Me 15 korrik 2015 me ndryshime ligjore⁶, u krijua baza që i mundësonte KGJK-së nxjerrjen e rregullores së veçantë që do përcaktonte procedurat e emërimit, kushtet, të drejtat dhe detyrimet për ekspertë gjyqësorë, si dhe lartësinë e shpërblimit për punën e tyre. Kjo Rregullore⁷ është miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2015 por që siç u cek më lartë nuk është zbatuar asnjëherë deri më tani si rrjedhojë nuk ka pasur ndonjë emërim të ekspertëve gjyqësore.

Në anën tjetër, legjislacioni i zbatueshëm respektivisht Kodi i Procedurës Penale dhe Ligji i Procedurës Kontestimore prek çështjet e ekspertëve gjyqësorë vetëm në funksion të mbarëvajtjes së procedurës gjyqësore, por që nuk rregullon në detaje çështjet e integritetit dhe profesionalizmit dhe çështje tjera të rëndësishme për procesin e emërimit të tyre.

1.2. ZBATIMI I ACQUIS SË BE-SË DHE STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE

Gjatë përgatitjes së këtij Koncept Dokumenti, Ministria e Drejtësisë ka vërejtur se çështja e ekspertizave gjyqësore nuk është e rregulluar në detaje dhe si rrjedhojë nuk është e standardizuar në nivel të BE-së.

⁶ Ligji Nr. 05/L-032 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-199 për Gjykatat, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18302>

⁷ Rregullore (15/2015) për Emërimin e Ekspertëve Gjyqësorë, <https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/Rregullorja%2015%202015.pdf>

1.2.1 Udhëzuesi mbi Praktikën e Mira në Ekspertizë Gjyqësore Civile në Bashkimin Evropian

Në kontekst të BE-së, për këtë Koncept Dokument vlen të veçohet Udhëzuesi mbi Praktikën e Mira në Ekspertizë Gjyqësore Civile në Bashkimin Evropian⁸, dokument ky i komisionuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Drejtësisë e Komisionit Evropian, i përpiluar nga Udhëzuesi Evropian për Ekspertizë Ligjore, komunitet i përbërë nga gjyqtarë, avokatë, ekspertë gjyqësorë, akademikë dhe studentë të drejtësisë.

Ky Udhëzues vendos disa bazamente të qëndrueshme sa i përket fushës së ekspertëve gjyqësorë. Një ndër me të rëndësishmet është se tenton të bëjë dallimin ndërmjet ekspertëve që angazhon gjykata dhe ekspertëve që angazhojnë palët, betimi i tyre se do të kryejnë detyrën me nder dhe me profesionalizëm, dhe se interesat e drejtësisë do të mbizotërojnë mbi ato të palës që i ka angazhuar. I njëjti shtjellon po ashtu kushtet që duhet plotësuar për të kërkuar ekspertizë gjyqësore dhe kushtet për emërimin e ekspertëve. Në këtë drejtim, ky Udhëzues cek se: *“Në lidhje me regjistrin e ekspertëve dhe futjen në këtë regjistrë, institucioni kompetent në [...] duhet të kontrollojë së paku kompetencën teknike të ekspertit duke parë provat e (i) kualifikimeve të ekspertit, (ii) përvojën profesionale, (iii) njohuri për teknikat e hetimit, (iv) njohuritë ligjore sa u përket standardeve që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së tij kryesore dhe rregullat që kanë të bëjnë me detyrimet dhe të drejtat e ekspertëve, si dhe me parimet udhëzuese të gjykimit të drejte dhe të ndershëm. Këto organe gjithashtu duhet të sigurojnë që Eksperti është i mbuluar më polise sigurimi për çdo përgjegjësi juridike civile. Ky sigurim duhet të bëhet nga një kompani e denjë sigurimi.”*

Për më tepër, në këtë Udhëzues ceket se nëse institucioni që është kompetent për të mirëmbajtur regjistrin / listën, veçanërisht nëse kjo është gjykata, ajo nuk mund të zëvendësojë universitetet në vlerësimin e kualifikimeve të ekspertit, megjithatë mundet të bëjë verifikimin e njohurive dhe aftësive të ekspertit duke iu referuar posaçërisht pikave si në vijim:

- diploma universitare
- përvojë profesionale e shënuar në CV-në e tij,
- reputacion profesional,
- anëtarësimi në shoqata profesionale,
- referencat,

⁸ <https://experts-institute.eu/wp-content/uploads/2018/03/2016-01-07-eeee-guide-to-good-practices-egle-en-brochure.pdf>

- kualifikimet profesionale të ekspertit, së bashku me trajnimet fillestare dhe të vazhdueshme,
- botimet përkatëse,
- çmimet e marra,
- kurse dhe përvojë mësimore.

Më tutje, ky Udhëzues kërkon nga ekspertët gjyqësorë që të japin betimin para se të futen në regjistër. Duke dhënë këtë betim, eksperti do të betohet se do t'i vë aftësitë e tij në shërbim të drejtësisë me ndershmëri, objektivitet, besnikëri, pavarësi dhe paanësi.

1.2.2. Udhëzuesi për rolin e ekspertëve të caktuar nga gjykata në procedurat gjyqësore të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës

Marrë parasysh fushëveprimin e këtij Koncept Dokumenti, hulumtimi i bërë për qëllime të këtij dokumenti është përqendruar edhe në dokumente të nxjerra nga Këshilli i Evropës.

Ky i fundit, përmes Udhëzuesit⁹ mbi rolin e ekspertëve gjyqësorë në procedurat gjyqësore të miratuar në vitin 2014, ka vendosur Udhëzuesin si një reference për ligjvënësit, gjyqtarin dhe të gjitha palët në një proces gjyqësor në lidhje me rolin e një eksperti teknik, në rastet kur eksperti udhëzohet nga gjykata, gjatë procesit të vendimit gjyqësor.

Sipas Udhëzuesit, gjykata mund të caktojë një ekspert por mundet edhe që t'u kërkojë palëve të bëjnë një propozim në lidhje me ekspertin. Nëse të dyja palët së bashku sugjerojnë të njëjtin ekspert, gjykata duhet ta pranojë këtë si kriterin kryesor të përzgjedhjes, por nuk është e detyruar nga sugjerimi i palëve.

Ky Udhëzues më tutje shtjellon çështjet se kush mund të caktohet si ekspert, mënyrat e emërimit / caktimit, kushtet dhe mënyrat se kur duhet kërkuar ekspertiza gjyqësore, të drejtat dhe obligimet e ekspertit, mundësitë e ri-emërimit ose ndëshkimit në rast të shkeljes së detyrave, efektet e ekspertizës, respektivisht se a duhet të jete obligative ekspertiza në procedurë gjyqësore. Për qëllim të këtij Koncept Dokumenti në vijim janë përshkruar kriteret e përzgjedhjes.

⁹ <https://rm.coe.int/168074827a>

Sipas Udhëzuesit, “gjkata – qoftë gjyqtari vendimmarrës apo administrata e gjykatës – duhet të caktojë një ekspert sipas kritereve të mëposhtme të përzgjedhjes.

Përcaktimi i njohurive të ekspertëve

Eksperti duhet të zotërojë një kualifikim të përshtatshëm dhe/ose përvojën ose aftësitë e nevojshme. Kualifikimi varet nga fusha e ekspertizës dhe nga detyra specifike. Ekspertët nga fusha e shkencës dhe kërkimit zakonisht kanë një ekspertizë të gjerë. Megjithatë, ekspertiza mund të fitohet përmes përvojës praktike. Prandaj, kërkesat në lidhje me kualifikimin e ekspertit ndryshojnë sipas profileve të ndryshme të punës dhe caktimit të detyrave.

Pavarësia faktike dhe paanshmëria personale

Eksperti duhet të mbetet i pavarur në lidhje me çështjen në shqyrtim dhe duhet të jetë i paanshëm në lidhje me marrëdhëniet me të dyja palët. Ai/ajo nuk duhet të lejohet të jetë caktuar nga njëra palë për të përgatitur një ekspertizë private gjatë fazës para-procedurale. Gjithashtu duhet të ndalohet që ai/ajo të qëndrojë në një marrëdhënie të ngushtë personale me njërin palë në mënyrë që të sugjerojë një konflikt interesi. Ai/ajo duhet të garantojë se mendimi i tij/saj jepet objektivisht dhe jo sipas interesave të mundshme personale.

Koha dhe kapaciteti teknik / aftësia personale

Eksperti duhet të ketë kohën dhe mjetet teknike për të kryer vlerësimin brenda orarit të menaxhimit të rastit dhe në mënyrë korrekte. Ai/ajo gjithashtu duhet të jetë personalisht në gjendje të kryejë vlerësimin dhe të jetë i disponueshëm për gjykim.

Kostot e parashikueshme

Tarifa më e ulët për orë nuk duhet të jetë kriter përzgjedhjeje, sepse rreziku i moscaktimit të një eksperti të pavarur dhe kompetent mund të lindë lehtësisht. Megjithatë, kostot e ekspertëve duhet të kihen parasysh kur zgjidhni një ekspert dhe të varen nga shumat në mosmarrëveshje. Për shkak të kësaj, mund të jetë e nevojshme të caktohet një ekspert potencial lokal për të minimizuar shpenzimet. Për më tepër, kostot e vlerësuara të vlerësimit të ekspertëve duhet të vihen në vëmendje të palëve në fazën më të hershme të mundshme.

Nëse nuk ka një sistem të përcaktuar me ligj për shpërblimin e ekspertëve të caktuar nga gjykata, kostoja mesatare e një eksperti duhet të merret si kriter i vlefshëm i përzgjedhjes.

Përvoja forenzike / eksperti i profesionit

Përzgjedhja e ekspertit nuk mund të varet nga fakti nëse eksperti ka pasur tashmë përvojë në vlerësimet gjyqësore. Nëse gjykata tashmë e njeh ekspertin dhe ai ia ka dëshmuar gjykatës aftësinë e tij, ajo lufton në favor të caktimit të këtij eksperti. Nga ana tjetër, është gjithashtu e rëndësishme të merret në konsideratë se një ekspert i cili caktohet gjithmonë për të njëjtin lloj pyetjesh ka rrezikun e mungesës së pavarësisë faktike.

Kuptueshmëria e gjuhës / kombësisë

Eksperti duhet të jetë në gjendje të paraqesë mendimin e tij ekspert në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme dhe, kur është e nevojshme, edhe në gjuhën e kërkuar zyrtare të përdorur në gjykatë. Ai/ajo gjithashtu duhet të zgjedhë një stil prezantimi i cili u mundëson adresuesve të mendimit të ekspertit – gjykatës dhe palëve – të kuptojnë deklaratat jo vetëm gjuhësore, por edhe përmbajtësore, dhe u mundëson adresuesve të bëjnë një vlerësim të provave.

Vendosmëria dhe referenca ndaj rezultateve

Eksperti duhet të jetë i vendosur në lidhje me pyetjet që merr dhe duhet të përpiqet t'u përgjigjet pyetjeve dhe të mos lërë asgjë të hapur. “Kurse sa i përket detyrimeve të eksperteve, ku dokument përcakton se këto detyrime përfshijnë:

- Eksperti duhet të prodhojë dhe raportojë personalisht mendimin e ekspertit. Ai/ajo duhet të marrë përgjegjësinë e plotë personale dhe nuk mund t'ia delegojë këtë përgjegjësi personave të tretë. Kjo është gjithashtu dhe veçanërisht nëse ai/ajo përdor shërbimet e punonjësve gjatë vlerësimit.
- Eksperti duhet të jetë jo vetëm i pavarur personalisht, por edhe i pavarur nga rezultati i padisë dhe gjithashtu nga interesat e palëve. Parimet e përgjithshme të pavarësisë dhe paanësisë duhet të respektohen dhe ndiqen. Për të qenë në gjendje të arrihen këto parime të përgjithshme, ekzistojnë parime dhe rregulla specifike të përgjithshme profesionale me të cilat eksperti duhet të respektojë.
- Eksperti duhet të ndjekë udhëzimet e tij duke pasur parasysh standardet aktuale të shkencës, teknologjisë dhe përvojës dhe me kujdesin e duhur. Ai/ajo duhet të

përcaktojë me zell sfondin aktual të vlerësimit të tij profesional/teknik dhe të shpjegojë rezultatet e vlerësimit të tij në një mënyrë të kuptueshme

- Eksperti gjatë kryerjes së detyrës dhe vlerësimeve të tij/saj duhet gjithmonë të ketë kujdes nga rreziku i subjektivizmit dhe paragjykimit. Gjatë përgatitjes dhe nxjerrjes së mendimit të ekspertit ai duhet të ruajë neutralitet të rreptë dhe t'u përgjigjet pyetjeve në mënyrë objektive dhe pa paragjykime (paanshmëri).
- Ekspertit i cili është udhëzuar ose emëruar në procedurën kontestimore nuk i lejohet të lidhë marrëveshje që mund të rrezikojnë paanshmërinë e tij, ose të bëjë pagesën e tij të varur nga rezultati i padisë. Gjithashtu i ndalohet të pranojë përfitime të tjera përveç tarifave dhe shpenzimeve të tij.
- Eksperti duhet të deklarojë që në fillim të procesit gjyqësor se nuk ka interes të përbashkët me njërin nga palët dhe nuk duhet të pranojë udhëzime për asnjë çështje ku mund të ekzistojë një konflikt aktual ose i mundshëm interesash. Pavarësisht nga ky rregull, eksperti mund të pranojë një udhëzim në rastet e duhura nëse i bëhet zbulimi i plotë gjyqtarit ose atyre që e caktojnë atë dhe nëse këta persona e pranojnë në mënyrë eksplicite udhëzimin në këtë situatë. Nëse pas udhëzimit të ekspertit ndodh një konflikt aktual ose i mundshëm interesash, ai/ ajo duhet të njoftojë menjëherë të gjitha palët e interesuara dhe mund t'i duhet të tërhiqet nga emërimi i tij në rastet përkatëse.
- Eksperti duhet të raportojë të gjitha rrethanat që mund të çojnë në dyshime në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e tij në këtë udhëzim specifik të ekspertit, p.sh. falimentimin e tij ose duke u bërë i pandehur në procedurë penale.
- Eksperti duhet të ruajë të gjitha informacionet në lidhje me rrethanat që ai/ ajo i ka përcaktuar gjatë gjetjes dhe vlerësimit të fakteve. Ndalohet që ai/ ajo të informojë persona të tretë të paautorizuar për njohuritë që ka marrë gjatë punës së tij/saj vlerësuese si ekspert ose t'i shfrytëzojë këto njohuri për përdorim nga të tjerët. Eksperti duhet të detyrojë punonjësit e tij/saj të respektojnë detyrën për të mbajtur konfidencialitet. Gjithashtu, detyra e konfidencialitetit vazhdon edhe nëse emërimi gjyqësor ka përfunduar.

Për të konfirmuar pavarësinë e tij, eksperti duhet të japë një garanci publike. Kjo zakonisht ndodh përmes dhënies së betimit në lidhje me detyrat e tij. Në rast se eksperti është dakord, ai/ ajo mund të betohet për paanshmëri vetëm një herë.

Po ashtu, eksperti duhet të zotërojë dhe të mbajë një nivel të lartë njohurish teknike dhe profesionale dhe/ose përvojë praktike në fushën e tij profesionale. Ai/ ajo duhet të ruajë njohuritë e tij jo vetëm në lidhje me ekspertizën e tij, por edhe me parimet që drejtojnë veprimtarinë e ekspertit. Ai/ ajo duhet të ndërmerr trajnime profesionale dhe kualifikime

arsimore në baza të rregullta për këto çështje. Në vende të caktuara, ekspertët kanë për detyrë të ndërmarrin edhe trajnime për rregullat e procedurës në lidhje me ekspertizën dhe rolin e ekspertit, si dhe për kushtet e pjesëmarrjes së ekspertit në seancat dëgjimore dhe paraqitjen e mendimit të tij/saj ekspert.

1.2.3 Raporti i CEPEJ10 mbi Sistemet gjyqësore evropiane - Botimi 2014: efikasiteti dhe cilësia e drejtësisë

Një tjetër dokument më rëndësi nga Këshilli i Evropës është Raporti i CEPEJ¹¹ mbi Sistemet gjyqësore evropiane - Botimi 2014 (të dhëna 2012): efikasiteti dhe cilësia e drejtësisë. Ky Raport vë në pah faktin se nuk ka as konsensus në nivel evropian, e as standard evropian se çka përbën ekspertët gjyqësorë. Ky studim definon ekspertizën gjyqësore si një: "masë vlerësuese për të cilën caktohet personi teknik, me miratimin e një gjykate ose një organi hetues, në mënyrë që të kontribuojë në zgjidhjen gjyqësore, duke sjellë prova teknike ose faktike". Një ekspert gjykate është një teknik (mjek, hidraulik, arkitekt, laborant mjekësor, etj.) i caktuar nga gjyqtari për të kryer këtë masë vlerësuese."

Sa i përket mënyrës së emërimit / caktimit të ekspertëve gjyqësorë, ky studim më tutje thekson që "ekspertët gjyqësorë mund të rekrutohen dhe / ose të emërohen nga gjykata. Gjithsej 14 shtete nuk konsiderojnë se gjykatat duhet të jenë përgjegjëse përcaktimin e ekspertëve gjyqësorë. Kur ekspertët nuk rekrutohen dhe / ose emërohen nga gjykata, zgjedhja e tyre sigurohet në të shumtën e kohës nga Ministria e Drejtësisë drejtpërdrejt ose përmes njërit prej organeve të saj (Azerbajxhani, Hungaria, Rumania, Serbia, Sllovakia, Slloveni).

Ekspertët gjithashtu mund të zgjidhen drejtpërdrejt nga palët (Qipro, Danimarkë, Irlandë, MB-Angli dhe Uells) apo edhe në mënyra të tjera, nga kreu i Agjencisë Shtetërore të Forenzikës (Federata Ruse). Si shembull, në Rumani, cilësia e ekspertit teknik gjyqësor fitohet bazuar në një provim / intervistë të organizuar nga Ministria e Drejtësisë. Personi

¹⁰ <https://rm.coe.int/cepej-report-on-european-judicial-systems-edition-2014-2012-data-effic/16807882a1#page441>

¹¹ <https://rm.coe.int/cepej-report-on-european-judicial-systems-edition-2014-2012-data-effic/16807882a1#page441>

që e fiton këtë titull regjistrohet nga Zyra Qendrore për Ekspertizën Teknike Gjyqësore brenda Ministrisë së Drejtësisë.

Ekspertët gjyqësorë rekrutohen dhe / ose emërohen nga një gjykatë në 33 shtete. Rekrutimi dhe / ose emërimi mund të jetë ose për një mandat specifik (ata mund të regjistrohen në një listë nga të cilin gjyqtari mund të zgjedhë ekspertët për një procedurë të caktuar), ose mbi një bazë *ad hoc*, sipas nevojave specifike të procedimit, siç është rasti në shumicën e shteteve ose enteve.

Ekzistojnë vetëm disa shtete ose subjekte ku ekspertët zgjidhen ekskluzivisht për një mandat specifik. Në Holandë, asnjë gjykatë nuk është përgjegjëse për emërimin. Rekrutimi dhe përzgjedhja bëhet nga prokurorët dhe shoqatat profesionale të ekspertëve gjyqësorë. Në Finlandë, autoriteti i apelit mund të marrë një mendim nga një ekspert individual për një çështje që kërkon ekspertizë të veçantë. Nëse një palë thërret një ekspert të pa emëruar nga autoriteti i apelit, mbi do të zbatohen dispozitat për dëgjimin e dëshmitarëve.

Ekspertët zgjidhen kryesisht mbi baza *ad hoc*, në përputhje me nevojat specifike të procedurave të dhëna. Pastaj, gjykatat i zgjedhin ata nga një listë zyrtare e siguruar nga Ministria e Drejtësisë (Bosnjë dhe Hercegovinë, Luksemburgu, Sllovakia, Suedia) ose nga një listë e personave të njohur për kompetencën e tyre (Portugali), nganjëherë me marrëveshjen e palëve (Luksemburg, Portugali)."

Ky Raport po ashtu cek se në 29 shtete ose subjekte, ekspertit gjyqësor i jepet një titull i mbrojtur; parakushtet ekzistojnë në mënyrë që të jenë i emëruar si ekspert gjyqësor (shpesh i lidhur me aftësitë dhe sjelljen etike) dhe puna e ekspertit ndiqet nga autoritetet (shpesh autoritetet gjyqësore). Në disa shtete anëtare, ekzistojnë shoqata (borde) ekspertësh të cilat mund të vendosen nën autoritetin e gjykatave.

1.3 Shtetet në rajon

Sa i përket legjislacioni të shteteve në rajon, shumica e tyre kanë rregulluar çështjen e ekspertëve gjyqësorë përmes ligjeve të veçanta. Në këto ligje janë të rregulluara kushtet për kryerjen e ekspertizës, procedura për emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve gjyqësorë, procedura për regjistrimin dhe fshirjen nga lista e personave fizikë dhe juridikë që kryejnë ekspertizë, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Maqedonia e Veriut

Nga shtetet në rajon, Maqedonia e Veriut ka ligjin¹² më të detajuar dhe kërkesa ligjore më strikte në lidhje me fushën e ekspertizave gjyqësore. Me këtë ligj shteti i Maqedonisë së Veriut rregullon çështjen e ekspertizës, respektivisht përcakton fushat ku kryhet ekspertiza, kushtet dhe mënyrën e kryerjes së ekspertizës, subjektet që mund të ofrojnë shërbime të ekspertizës si dhe çështjet që kanë të bëjnë me shpërblimin dhe rimbursimin e kostos së ndërlidhur me ekspertizat.

Për më tepër, ky ligj parasheh edhe kushtet dhe procedurën për dhënien e provimit profesional për lëshimin e licencës së ekspertizës si dhe themelimin, kompetencën, organizimin dhe funksionimin e Odës për ekspertët, përfshirë çështje të tjera me rëndësi për ekspertizë dhe super-ekspertizë.

Një ndër çështjet më interesante që parasheh Ligji për Ekspertiza është edhe themelimi i Byrosë së Ekspertizës Gjyqësore. Sipas Ligjit në fjalë, Byroja është organ i administratës shtetërore brenda Ministrisë së Drejtësisë, e cila kryen veprimtari profesionale në fushën e ekspertizës dhe super ekspertizë për nevojat e gjykatave dhe prokurorëve publikë në Republikën e Maqedonisë, për nevojat e organeve shtetërore, ndërmarrjeve publike, kompanive dhe fondeve të krijuara nga shteti, personave fizikë dhe juridikë, si dhe për subjektet e tjera për të cilat kërkohet ekspertizë.

Byroja, për nevojat e gjykatave dhe prokurorive publike, organeve shtetërore, ndërmarrjeve publike dhe kompanive të themeluara nga shteti, përgatit një Program për Ekspertizë dhe Vlerësime.

Fusha e Byrosë në fushën e ekspertizës përfshinë monitorimin e arritjeve shkencore, profesionale dhe teknike në kryerjen e ekspertizës dhe vlerësimeve, marrjen e masave për të përmirësuar punën, metodat e ekspertizës dhe zhvillimin profesional të punonjësve e bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Në kryerjen e aktiviteteve brenda fushëveprimit të tij dhe për aktivitete të caktuara nga kompetenca e Byrosë të cilët kërkojnë ekspertizë të veçantë, si dhe për kryerjen e së cilës nevojiten profesionistë apo pajisje që nuk i ka Byroja, kjo e fundit mund të arrijë një marrëveshje bashkëpunimi me një organ tjetër të administratës shtetërore, organit

¹² <https://pravda.gov.mk/toc1/460>

shtetëror, institucionit të arsimit të lartë, institucionit shkencor ose institucionit profesional për dhënien e ekspertizës apo vlerësimit.

Ministria e Drejtësisë është kompetente për lëshimin dhe revokimin e licencës së eksperteve gjyqësor. Derisa procedura disiplinore zhvillohet pranë Komisionit Disiplinor në Odën e Ekspertëve, si masë më e rëndë mund të rekomandohet tek Ministria e Drejtësisë revokimi i licencës. Licenca për ekspertizë revokohet edhe në rastet si në vijim:

- eksperti ka humbur aftësinë juridike,
- licenca është lëshuar në bazë të të dhënave të pasakta,
- eksperti në një procedurë pranë një organi kompetent, në të cilin ai kryen ekspertizën, është gjobitur tre herë në një vit kalendarik,
- ndalimi i kryerjes së një profesioni, veprimtarie është shqiptuar me vendim përfundimtar,
- është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër penale të dënueshme me burgim për më shumë se gjashtë muaj, dhe
- nëse eksperti nuk i ka paguar anëtarësinë vjetore Odës së Ekspertëve deri në fund të vitit aktual.

Regjistri i ekspertëve mirëmbahet nga Ministria e Drejtësisë.

Republika e Maqedonisë së Veriut përveç Ligjit për Ekspertiza ka edhe një ligj tjetër te veçantë që është Ligji për Vlerësime. Ky ligj rregullon kryerjen e vlerësimit, fushat, kushtet dhe mënyra e kryerjes së vlerësimit, subjektet që kryejnë vlerësimin, kushtet dhe procedurën e marrjes së provimit profesional me qëllim të lëshimit ose revokimit licencën për vlerësimin, shpërblimin dhe rimbursimin e kostove për vlerësimin e kryer, kompetenca, organizimi dhe funksionimi i Dhomës së Vlerësuesve të Republika e Maqedonisë, si dhe çështje të tjera që lidhen me vlerësimin.

Sipas këtij ligji, vlerësimi i vlerës së tregut të subjektit të vlerësimit, sipas kësaj ligji, kryhet në një mënyrë të përcaktuar nga metodologjia, rregullat dhe standardet për vlerësimet që përfshijnë Standardet Evropiane të Vlerësimit dhe kryhet në fushat e mëposhtme:

- shoqëria tregtare, ndërmarrja publike dhe personat e tjerë juridikë
- prona të paluajtshme;
- prona të luajtshme;
- llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet;
- makina dhe pajisje;
- mjetet e transportit;
- bujqësia, pylltaria dhe ekonomia e ujit;
- prona industriale;
- të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to;
- mbrojtja e mjedisit;
- teknologjia e informacionit;
- pajisje policore dhe ushtarake dhe
- fusha të tjera të përcaktuara me ligj.

Mali i Zi

Republika e Malit të Zi po ashtu ka një ligj të veçantë në lidhje me ekspertët gjyqësorë. Ligji për Ekspertët Gjyqësorë rregullon kushtet për kryerjen e ekspertizës, procedurën për emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve të gjykatës, përkatësisht regjistrimin e personave juridikë në regjistrin e personave juridikë për kryerjen e ekspertizës, të drejtat dhe detyrat e ekspertëve, si dhe çështje të tjera të rëndësishme për punën e tyre.

Ekspertiza parashihet të kryhet nga persona fizikë dhe juridikë që plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligj, si dhe nga institucionet shkencore dhe profesionale dhe organet e tjera brenda të cilave mund të kryhet ekspertiza, përfshirë edhe nga shtetet e tjera në rastet kur nuk ka ekspertë të atij profili në shtetin e Malit të Zi.

Një person fizik mund të emërohet si ekspert nëse përveç kushteve të përgjithshme për punë në organet shtetërore, ai/ajo ka arsim të lartë, dhe ka të paktën pesë vjet përvojë pune në profesion, si dhe posedon njohuri profesionale e përvojë praktike për një fushë të caktuar të ekspertizës. Mirëpo, ka raste kur nuk ka numër të mjaftueshëm të ekspertëve për një fushë të caktuar, si ekspert mund të emërohet gjithashtu edhe individ i qe ka arsimim të mesëm. Kurse sa i përket personave juridikë, ata mund të kryejnë një ekspertizë nëse janë regjistruar në Regjistrin Qendror të Subjekteve të Biznesit në të cilin mund te regjistrohen nëse kanë një ekspert të punësuar i cili është emëruar në përputhje me këtë ligj.

Ekspertët emërohen nga Komisioni i emëruar nga Ministri i Drejtësisë i cili në përbërje ka një anëtar nga radhët e gjyqtareve dhe një anëtar nga radhët e prokurorëve, dy anëtar nga Shoqata e Ekspertëve Gjyqësorë dhe një anëtar nga Ministria e Drejtësisë.

Njohuritë e ekspertëve dhe përvoja praktike për një fushë të caktuar të ekspertizës për personat të cilët caktohen si ekspertë për herë të parë, përcaktohen nga një verifikim i kryer nga një ekip ekspertësh i përbërë nga të paktën dy (2) ekspertë të profesionit përkatës, të paktën një gjyqtar dhe një prokuror shteti.

Ligji i Malit të Zi nuk ka dispozita konkrete sa i përket disiplinimit, megjithëse cek se një ekspert nuk mund të kryejë një ekspertim nëse kundër tij është marrë vendim për nisje hetimeve ose është ngritur një për një vepër penale që e bën atë të papërshtatshëm për të kryer një ekspertim gjatë procedurës penale.

Po ashtu, edhe shkarkimi i ekspertëve bëhet nga Komisioni i themeluar nga Ministria e Drejtësisë, me propozim nga kryetari i gjykatës, kryeprokurori i shtetit, eprori i një organi tjetër që zhvillon procedurat, gjyqtari dhe prokurori i shtetit në rastin e të cilit ka vepruar eksperti.

Eksperti do të shkarkohet edhe në raste si në vijim:

- me kërkesë të tij/saj;
- pushon së përmbushuri kushtet për kryerjen e ekspertizës;
- është dënuar me burgim ose është shpallur fajtor për një vepër që e bën atë të paaftë për të kryer një ekspertizë;
- i shqiptohet një masë sigurie që e ndalon atë të kryejë veprimtari në zonën në të cilën ai fitoi titullin e ekspertit;
- zotësia e tij juridike është revokuar ose kufizuar në bazë të një vendimi gjyqësor;
- është vërtetuar se eksperti ka humbur aftësinë e tij / saj për të punuar, në përputhje me ligjin;
- kryen ekspertizë të besuar në mënyrë të pahijshme ose joprofesionale.

Serbia

Serbia ka Ligjin për Ekspertë Gjyqësorë, sipas të cilit ligj rregullon kushtet për kryerjen e ekspertizës, procedurën e emërimit dhe shkarkimit të ekspertëve të gjykatës, procedurën

e regjistrimit dhe fshirjes së personave juridikë që kryejnë ekspertizën, si dhe të drejtat dhe detyrimet e personave që kryejnë ekspertizën.

Eksperti emërohet dhe shkarkohet nga Ministria e Drejtësisë dhe ministri gjithashtu vendos për regjistrimin dhe fshirjen e personave juridikë në Regjistrin e Personave Juridikë për kryerjen e ekspertizës.

Sa i përket kushteve që duhet plotësuar, Ligji për Ekspertë Gjyqësorë në Serbi ka paraparë që një person fizik mund të emërohet si ekspert nëse, përveç kushteve të përgjithshme për punë në organet shtetërore të përcaktuara me ligj, ai gjithashtu plotëson kushtet e mëposhtme të veçanta:

- 1) të ketë një arsim të lartë të përshtatshëm në studimet e shkallës së dytë (studime akademike pasuniversitare - master, studime akademike të specializuara, studime profesionale të specializuara), pra në studimet bazë, për një fushë të caktuar të ekspertizës;
- 2) të ketë të paktën pesë vjet përvojë pune në profesion;
- 3) të ketë njohuri profesionale dhe përvojë praktike në një fushë të caktuar të ekspertizës;
- 4) të jetë i denjë për të kryer punë eksperte.

Në rast të jashtëzakonshme, nëse nuk ka ekspertë të mjaftueshëm me arsim të lartë të fituar për një fushë të caktuar të ekspertizës, një person mund të emërohet si ekspert edhe nëse e ka përfunduar vetëm shkollën e mesme.

Kurse sa i përket personave juridikë, një person juridik mund të kryejë ekspertizë nëse plotëson kushtet e mëposhtme:

- 1) se është regjistruar në regjistrin e organit kompetent për veprimtarinë e ekspertizës në fushën përkatëse;
- 2) që personi juridik punëson persona të regjistruar në Regjistrin e Ekspertëve.

Po ashtu, ky Ligj parasheh që ekspertiza mund të kryhet edhe nga organet shtetërore brenda të cilave mund të kryhet ekspertiza, si dhe institucionet shkencore dhe profesionale (fakultetet, institutet, entet, etj.). Në këto rast, organet dhe institucionet e

përmendura do të emërojnë një ose më shumë ekspertë të specialitetit të duhur, të cilët do të kryejnë ekspertizë ose do të formojnë komisione të përbërë nga punonjës shkencorë ose profesionistë të punësuar prej tyre.

Ministri emëron ekspertët gjyqësor si dhe i shkarkon ata në bazë të propozimit të kryetarit të Gjykatës, në sajë të të cilit propozim Ministri formon një Komision të veçante për të trajtuar propozimin e Kryetarit të Gjykatës. Shkaqet që një ekspert mund të shkarkohet janë:

- 1) me kërkesën të tij/saj;
- 2) nëse përcaktohet se kushtet mbi bazën e të cilave ai ishte emëruar nuk ekzistonin, domethënë se ato pushuan së ekzistuari;
- 3) nëse ai është dënuar për një vepër penale që e bën atë të padenjë ose të papërshtatshëm për të kryer punë e ekspertit;
- 4) nëse i shqiptohet një masë e sigurisë që e ndalon atë të kryejë veprimtari në zonën në të cilën ai kryen ekspertizë;
- 5) nëse, në bazë të një vendimi gjyqësor, aftësia e tij ligjore hiqet ose kufizohet;
- 6) nëse përcaktohet në mënyrën e përcaktuar me ligj se ai ka humbur aftësinë e tij për të punuar;
- 7) nëse ai kryen një ekzaminim eksperti në mënyrë të çrregullt, të paskrupullt ose joprofesionale.

Për më tepër, ky ligj përcakton se kur eksperti kryen një ekspertizë në mënyrë të çrregullt dhe të paskrupullt (sipas pikës 7 më lartë) nëse ai refuzon në mënyrë të pajustificuar të jetë dëshmitar ekspert, nuk i përgjigjet thirrjeve gjyqësore ose organi tjetër që kryen procedurën, nuk e kryen ekspertizën brenda afatit të përcaktuar në raste të tjera të parashikuara me ligj. Kurse kur eksperti përmes ekspertizës jep gjetje jo të plota, të paqarta, kontradiktore ose të pasakta konsiderohet se ka kryer ekspertizën në mënyrë joprofesionale.

Kroacia

Fushën e ekspertëve gjyqësorë Kroacia e rregullon përmes Ligjit për Gjykata¹³ i cili ndër të tjera përcakton se ekspertët e përhershëm të gjykatës, bazuar në njohuritë e tyre profesionale, i ofrojnë gjykatës shërbimin e ekspertizës kur është e nevojshme në mënyrë që të vërtetohen ose sqarohen faktet e vendosura në procedurë. Në Kroaci, gjatë procesit të emërimit si ekspert, kandidatët duhet që të kalojnë me sukses provimin mbi njohuritë mbi strukturën e gjyqësorit, administratën shtetërore dhe terminologjinë juridike¹⁴.

Në rregullimin juridik kroat është paraparë që ekspertizën mund ta ofrojnë personat fizikë dhe juridikë. Tek personat fizikë ka paraparë që kualifikimet minimale të jenë studime universitare ose pasuniversitare. Përfundimisht, një person fizik i cili ka mbaruar arsimin e mesëm në profesionin përkatës mund të emërohet si ekspert i përhershëm i gjykatës.

Ndërsa, personat juridikë mund të kryejnë ekspertizë gjyqësore vetëm brenda fushës së veprimtarisë së tyre të regjistruar, me kusht që kjo të bëhet nga punonjësit e tyre që plotësojnë kushtet e përmendura përkitazi me personat fizikë.

Sa i përket autoritetit të emërimit dhe shkarkimit, ekspertët e përhershëm gjyqësorë i emëron Kryetari i Gjykatës së Rrethit apo Gjykatës Ekonomike për juridiksionin territorial të gjykatës, me mandat katër (4) vjeçar me mundësi riemërimi. Pas emërimit, ekspertët mund të ofrojnë shërbimet e tyre në territorin e tërë Republikës së Kroacisë.

Procedura e ankesës është e rregulluar në atë mënyrë që kundër vendimit të Kryetarit të Gjykatës që refuzon kërkesën për emërimin e ekspertit gjyqësor, ankuesi ka të drejtë të ankohet kundër vendimit në Ministrinë e Drejtësisë. Vendimi i Ministrit të Drejtësisë është përfundimtar.

Në vazhdim, sa i përket kushteve dhe kriterëve më të detajuara për emërimin e ekspertëve gjyqësorë, edhe pse emërohen nga Gjykata, Ministri i Drejtësisë përcakton me Rregullore kushtet dhe procedurat për emërimin e ekspertëve të përhershëm të gjykatës, të drejtat dhe detyrat e tyre, si dhe shumën e shpërblimit dhe rimbursimit të shpenzimeve për punën e tyre.

¹³ Ligji për Gjykata, Republika e Kroacisë, https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2013_03_28_473.html

¹⁴ Neni 2 (4), Rregullore mbi Ekspertët e Përhershëm Gjyqësorë, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kroacisë, [www.sudski-vjestaci.hr/fdsak3jnFsk1Kfa/dokumenti/Pravilnik_o_stalnim_sudskim_vjestacima_procisceni_tekst_\(1\)_\(2\).pdf](http://www.sudski-vjestaci.hr/fdsak3jnFsk1Kfa/dokumenti/Pravilnik_o_stalnim_sudskim_vjestacima_procisceni_tekst_(1)_(2).pdf)

Regjistri i eksperteve gjyqësorë, përkatësisht personave juridikë që kryejnë ekspertizë gjyqësore dhe ekspertë të përhershëm të gjykatave për të gjitha gjykatat publikohet në ueb faqen e Ministrisë së Drejtësisë.

Shqipëria

Republika e Shqipërisë për dallim nga shtete tjera në rajon, nuk ka ndonjë ligj të veçantë për rregullimin e ekspertimit gjyqësor. Më saktësisht, Shqipëria këtë materie e rregullon parimisht përmes Kodi të Procedurës Civile (neni 224/d) i cili cek se:

1. Ministria e Drejtësisë krijon, administron dhe vë në dispozicion për publikun një regjistrë elektronik për ekspertët. Ky regjistër ndahet në seksione të ndryshme, duke grupuar ekspertët, sipas fushave të tyre të ekspertizës dhe vendit ku ata punojnë.
2. Gjyqtari cakton një ekspert jashtë regjistrit elektronik, vetëm kur, për nevoja të procesit, eksperti nevojitet nga fusha të veçanta ekspertize, për të cilat ligji nuk parashikon licencimin e tyre.
3. Ministria e Drejtësisë pranon regjistrimin e ekspertit në regjistrin elektronik, nëse ai përmbush kriteret e mëposhtme:
 - a) të ketë dhjetë vjet përvojë profesionale në fushën specifike apo të ngjashme. Pesë vjet përvojë profesionale e këtij lloji është e mjaftueshme nëse aplikanti ka përfunduar një trajnim profesional në fushën përkatëse;
 - b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - c) të jetë i regjistruar dhe të ketë përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet në organet tatimore.
4. Regjistri elektronik duhet të parashikojë një rubrikë të veçantë, ku palët e interesuara mund të vlerësojnë ekspertin në lidhje me ekspertizat e tij në të shkuarën, duke përdorur një sistem pikëzimi.

Po ashtu edhe Kodi i Procedure Penale trajton çështjen e ekspertëve gjyqësorë vetëm në raport me caktimin e tyre për nevoja të procedurës penale, por nuk jep ndonjë kriter të përgjithshëm sa i përket asaj se kush mund të caktohet ekspert apo jo.

Një element interesant që vihet re në legjislacionin shqiptar, është vlerësimi i ekspertëve nga ana e palëve, duke iu mundësuar palëve vlerësimin e ekspertit në lidhje me ekspertizën e dhënë duke përdorur një sistem pikëzimi.

Ministria e Drejtësisë, në dritë të ndryshimit të Kodit të Procedurës Civile, ka nxjerrë Udhëzimin nr. 10619, datë 19.10.2018, “Për krijimin, administrimin dhe vënien në dispozicion për publikun të Regjistrat Elektronik për Ekspertët”. Në këtë Udhëzim janë paraparë procedurat e regjistrimit të ekspertit në regjistër të eksperteve, mënyrat si bëhet kërkesa dhe vlerësimi i dokumentacionit, si dhe shkaqet kur një ekspert mund të pezullohet apo hiqet nga regjistri.

Kriteret e parapara me këtë Udhëzim janë si ne vijim:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të ketë dhjetë vjet përvojë profesionale në fushën specifike apo të ngjashme ose pesë vjet përvojë profesionale e këtij lloji, nëse aplikanti ka përfunduar një trajnim profesional në fushën përkatëse;
- të jetë i regjistruar dhe të ketë përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet në organet tatimore;
- të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prere:
 - a. për një vepër penale të kryer me dashje, për të cilën nuk është rehabilituar;
 - b. për një vepër penale të kryer me pakujdesi, për të cilën nuk është rehabilituar dhe që cenon figurën dhe integritetin e profesionit të ekspertit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi që normon ushtrimin e profesionit përkatës;
 - c. për një vepër penale të kryer me dashje, për të cilën është rehabilituar, kur vepra penale cenon figurën dhe integritetin e profesionit të ekspertit sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi që normon ushtrimin e profesionit përkatës.

Ministria e Drejtësisë është kompetente për heqjen apo çregjistrimin e ekspertit nga regjistri pas ankesave të parashtruara nga institucioni ku është i angazhuar personi/eksperti për dhënien e ekspertizës. Në këto raste Ministria e Drejtësisë i jep mundësinë edhe ekspertit të parashtoj faktet në lidhje me rastin e tij. Nëse vërtetohet mos përmbushja e detyrimeve ligjore Ministria e Drejtësisë bën çregjistrimin e ekspertit nga Regjistri Elektronik i Eksperteve dhe i njofton rezultatet e verifikimit institucionit përgjegjës që ka licencuar ekspertin.

Përmbledhje e të gjeturave kryesore nga shtetet ne rajon

Tabela ne vijim tregon mënyrat se si shtetet e ndryshme ne region kanë rregulluar çështjen e legjislacionit:

Shteti	Ligj i veçantë	Emri i ligjit	Autoriteti licencues	Odë të veçantë	Autoriteti disiplinor
Maqedonia e Veriut	Po	Ligji për ekspertizë	Ministria e Drejtësisë	Po	Komisioni Disiplinor i Odes
Mali i Zi	Po	Ligj për ekspertët gjyqësorë	Komision i themeluar nga Ministria e Drejtësisë (MD)	Jo	Ministria e Drejtësisë (Komision i themeluar nga MD)
Serbia	Po	Ligj për ekspertet gjyqësorë	Ministria e Drejtësisë	Jo	Komision i themeluar nga Ministria e Drejtësisë
Kroacia	Jo	Ligji për gjykatat (nenet 125-127)	Kryetari i Gjykatës se qarkut / ekonomike	Jo	Kryetari i Gjykatës se rrethit / ekonomike
Shqipëria	Jo	Kodi i Procedurës Civile i RSH, i ndryshuar	Ministria e Drejtësisë (sistem te thjeshtëzuar të licencimit)	Jo	MD pezullon / largon nga regjistri ne baze te ankesës

1.4 Korniza e politikave dhe e legjislacionit të Kosovës

Në Republikën e Kosovës, ekziston një nivel i normimit lidhur me ekspertizat gjyqësore. Kjo kornizë ligjore, e cila është objekt elaborimi edhe në tabelën e mëposhtme, përbëhet nga aktet ligjore si në vijim:

1. *Ligji për Gjykatat;*
2. *Kodi i Procedurës Penale;*
3. *Ligji për Procedurën Kontestimore;*
4. *Ligji për Procedurën Jo-Kontestimore*
5. *Ligji për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë;*
6. *Ligji për Mjekësinë Ligjore;*
7. *Ligji për sistemin e lejeve dhe Licencave;*
8. *Rregullore e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (15/2015) për emërimin e ekspertëve gjyqësorë.*
9. *Kodi i procedurës penale*
10. *Ligji për trafikun publik*
11. *Ligji i procedurës përmbartimore*

Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Lidhja me Gazetën Zyrtare	Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302	Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykatat	Hartimi i legjislacionit (sekondar) dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit: Këshilli Gjyqësor i Kosovës me ndryshimet e bëra në Ligjin për Gjykata në vitin 2015 i është dhënë kompetencë që të nxjerrë Rregullore te veçantë. Ligji për Gjykata që është aktualisht në fuqi, përcakton se “Këshilli Gjyqësor i Kosovës me akt nënligjor përcakton procedurat e certifikimit dhe emërimit, kushtet, të drejtat dhe detyrimet për përkthyes, interpret dhe <u>ekspertë gjyqësor</u>, si dhe lartësinë e shpërblimit për punën e tyre.” Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nxjerrë Rregulloren 2015/15 për eksperte gjyqësor por që përves pjesës se kompensimeve të ekspertëve gjyqësorë, e njëjta nuk është zbatuar dhe si rrjedhojë asnjë eksperte gjyqësorë nuk është emëruar që nga viti 2012.
Kodi i Procedurës Penale	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861	Prokuroritë, Gjykatat	Me Kodin e Procedurës Penale nga neni 136-142 parashihet Ekspertimi, roli i Prokurorit dhe kushtet apo rrethanat se kur mund të kërkohej përdorimi i ekspertizës, kush mund të jete ekspertët, si bëhet angazhimi i tyre apo përmbajtja e vendimit, raporti i ekspertit, urdhrat e nevojshëm për shqyrtimin e provave, deklarata e ekspertit ne procedure paraprake etj.

Ligji për Procedurën Kontestimore	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2583	Gjykatat, (palët ne procedure)	Gjykata me propozimin e palëve mund të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes. Çështje e ekspertimit ne procedure kontestimore është e rregulluar me nenet 356-372.
Ligji për Procedurën Jo-Kontestimore	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18304	Gjykata, Institucionet shëndetësore,	Me këtë ligji caktohen rregullat sipas të cilave gjykatat veprojnë dhe vendosin mbi të drejtat dhe interesat personale, familjare dhe të drejtave të tjera dhe interesave juridike dhe pasurore që zgjidhen në procedurën jokontestimore.
Ligji për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2781	Agjencinë e Kosovës për Forenzikë	Agjencia e Kosovës për Forenzikë është institucioni përgjegjës për ofrimin e paanshëm, të analizave objektive shkencore forenzike. AKF-ja i kryen veprimet me urdhër të gjykatës, prokurorisë apo me kërkesë të agjencive të zbatimit të ligjit.
Ligji për Mjekësinë Ligjore	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12325	Instituti i Mjekësisë Ligjore	Nga ana e Institutit të Mjekësisë Ligjore kryhen Ekzaminimet mjeko ligjore, si: autopsia mjeko ligjore, ekzaminimi klinik mjeko ligjor, ekzaminimi i mostrave biologjike, si dhe ekzaminimet tjera mjeko ligjore të parapara me këtë ligj.

Ligji për sistemin e Lejeve dhe Licencave	https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8967	Institucionet Publike ne Republikën e Kosovës	Ky ligj ka për qëllim të vendos parimet dhe rregullat për përmirësimin e mjedisit për të bërë biznes, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, që është e domosdoshme për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë publike, mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore në Republikën e Kosovës.
Rregullore për emërimin e ekspertëve gjyqësorë	https://www.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/lgsi/Rregullorja%2015%202015.pdf	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Me këtë Rregullore përcaktohen procedurat e emërimit të ekspertëve gjyqësor, kushtet, te drejtat dhe detyrimet për ekspertet gjyqësorë, lartësia e shpërblimit dhe mënyra e kompensimit për punën e tyre.
Projekt Kodi i procedurës penale ¹⁵	https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Projekt_kodiiprocedur_espenele_Gf9pKN5s3w.pdf	Prokuroritë, gjykatat, policia, institucionet tjera zbatuese të ligjit.	Ky Projekt Kod ka për qëllim përcaktimin e rregullave të procedurës penale të cilat janë të detyrueshme për punën e gjykatave, prokurorisë së shtetit si dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurën penale të paraparë me këtë Kod. Sa i përket ekspertimit, ky Projekt Kod në dispozitat nga neni 133 deri në nenin 146 rregullon çështjet e ekspertimit, raportit të ekspertimit, vendimi për angazhimin dhe detyrimet e ekspertit, deklaratat e ekspertit në procedurë penale dhe çështjet e tjera relevante.

¹⁵ Projekt Kodi i Procedurës Penale është në procedurat e miratimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht si i tillë nuk është ende në fuqi. Mirëpo, për shkak të relevancës dhe ndikimit në hartimin e kësaj politike është vlerësuar se i njëjti të pasqyrohet në tabelën e mësipërme.

Ligji i procedurës përmbaremore	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2870	Gjykatat dhe Përmbareuesit Privat.	Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përmbareuesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbareimin në bazë të dokumenteve përmbareues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe. Krahas procedurës së përmbareimit, ekspertizat dhe ekspertet caktohet nga organi përmbareues (gjykata dhe përmbareuesit privat).
Ligji për trafikun publik	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12822	Gjykatat, prokuroritë, policia.	Ky ligj ka për qëllim t'i përcaktojë rregullat bazë të sjelljes së pjesëmarrësve dhe subjekteve të tjera në trafikun rrugor, sistemin e sinjalizimit të trafikut rrugor, shenjat që i japin personat e autorizuar zyrtarë, detyrat në rast aksidenti në trafikun rrugor dhe çështje të tjera.

1.5 Elaborimi i problemit kryesor

Një ndër çështjet që kërkon urgjencën më të madhe për trajtim në sferën e gjyqësorit është çështja e ekspertëve gjyqësorë, pasi që aktualisht çështja e ekspertëve gjyqësor është sferë tërësisht e parregulluar.

Lista e ekspertëve gjyqësorë

Lista e ekspertëve me të cilat operojnë (ose ish dashur të operojnë) gjykatat dhe prokuroritë është e vitit 2004 nga koha e Misionit të UNMIK-ut¹⁶ dhe çdo plotësim shtesë me ekspertë të rinj është bere nga gjykatat në mënyrë vetanake dhe pa ndonjë koordinim me nivelin qendror. Për më tepër, të gjithë bashkëbiseduesit kanë konfirmuar se në të shumtën e rasteve ftojnë individë në cilësinë e ekspertit edhe individë të cilët nuk figurojnë fare në listë të ekspertëve.

Plotësimi pa ndonjë kriter dhe rregull i Listës së ekspertëve gjyqësorë ka vazhduar deri në hyrjen në fuqi të Ligji për Gjykata (2013). Fatkeqësisht, ky Ligj i ri ka dështuar së adresuari fare çështjen e ekspertëve gjyqësorë duke krijuar një vakum ligjor, i cili është adresuar me plotësim ndryshim të Ligjit për Gjykata ne vitin 2015 ku dhe është krijuar baza ligjore qe KGJK të nxjerrë Rregulloren për ekspertë gjyqësore.

Megjithatë, edhe pas gjashtë (6) viteve, KGJK nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për licencimin e ekspertëve dhe nxjerrjen e një regjistri të ri të ekspertëve gjyqësorë. KGJK-ja nuk ka ndonjë arsyetim adekuat se përse nuk e kanë zbatuar Ligjin për Gjykata sa i përket procesit të emërimit të ekspertëve gjyqësore përkundër faktit se Rregullorja për emërimin e eksperte është nxjerre dhe ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2015.

Emërimi /shkarkimi

Duke qenë se ekspertët gjyqësor që japin ekspertiza gjyqësore nuk iu kanë nënshtruar procesit të emërimit, si rrjedhojë nuk mund të i nënshtrohen as procesit të shkarkimit. Në pjesën e lartë të këtij koncept dokumenti u elaborua se gjyqtarët dhe prokurorët kane hasur në disa parregullsi të ekspertizave por përveç ndonjë gjobe sporadike që ka ndodhur nuk kane pasur mundësi te kërkojnë marrje e licencës se ekspertit gjyqësor pasi qe nuk e kanë një të tillë.

Janë jo të rralla rastet kur ka pasur vonesa të mëdha të shkaktuara nga eksperti gjyqësor në dhënien e ekspertizës, gjë që pashmangshëm kontribuon edhe në zvarritjen e lëndëve gjyqësore. Po ashtu, ka rast edhe kur ekspertiza nuk trajton në saktësi atë që është kërkuar

¹⁶ E njëjta vlen edhe për listën me gjyqtarë porotë.

më kërkesë të gjykatës.¹⁷ Kjo shkakton edhe probleme tjera në institucione gjyqësore dhe prokuroriale se derisa është në listë, ai ekspert duhet që të thirret për të dhënë ekspertizë gjyqësore të cilëve edhe u besohet ndoshta edhe vendimmarrja pasi që në të shumtën e rasteve gjykata ia fal besimin të gjeturave dhe konstatimeve të ekspertëve gjyqësor. Si rrjedhojë, ligji i ri do duhet të vë në pah faktin se ekspertiza gjyqësore është vetëm një nder provat e administruara dhe jo prova e vetme mbi të cilën duhet bazuar aktgjykimin.

Për shembull, në një rast civil për kompensim dëmi, ekspertiza ka konstatuar se dëmi i shkaktuar kap vlerën 2,000 EUR kurse i tërë automjeti sipas një hulumtimi të thjeshtë të tregu në mesatare kushton 800 EUR, mirëpo, meqë nuk ka pasur ndonjë kontestim nga ana e palëve gjykata duhet ta pranojë atë ekspertizë.

Gjatë konsultimit paraprak përmes intervistimit të përfaqësuesve të ndryshëm institucional, është potencuar po ashtu se në të njëjtën lëndë gjyqësore dy ekspertë të lëmisë së njëjtë, të angazhuar nga palët ndërgjyqëse kanë dhënë ekspertizë totalisht të ndryshme mbi faktet e njëjta. Në raste të tilla, kur edhe pse eksperti angazhohet nga vetë palët, pritet që eksperti të ruajë një nivel të caktuar integriteti e profesionalizmit dhe të mos bëjë ekspertizë gjyqësore që është edhe kundrejt fakteve në terren. Në këto raste, natyrisht zgjidhja është e ashtuquajtura super-ekspertizë por që në këto raste, lënia në heshtje e ekspertizës gjyqësore që ka tentuar të vë në lajthitje sistemin gjyqësor nuk bën të lihet në heshtje dhe si rrjedhojë duhet të parashihet iniciimi i proceseve disiplinore.

Mosekzistimi i një mekanizmi ku paraqiten pakënaqësitë ndaj punës së ekspertëve

Licencimi dhe angazhimi i ekspertëve duhet të rregullohet asisoi që paraprakisht të përmbushin kriteret në lidhje me integritetin dhe aftësitë profesionale dhe kompetencës. Autoriteti që administron listat duhet të sigurojë pajtueshmëri me standardet etike dhe profesionale. Megjithatë, ajo që paraqet sfidë është fakti që palët që mund të jenë të pakënaqura me punën e ekspertëve gjyqësorë, nuk kanë një vend të vetëm ku do të mund të venin në pah punën e tyre apo çështjet në lidhje me integritetin e tyre.

Frekuenca e angazhimeve si ekspert

Disa nga ekspertet me të cilat MD ka biseduar gjatë përpilimi të këtij Koncept Dokumenti kanë treguar se nuk ka ndonjë radhitje të ftesës së ekspertëve pasi që ata pretendojnë se palët në procedurë (avokati, prokurori, etj) janë të lidhur me disa ekspertë të caktuar dhe nuk parandodh që gjyqtari të i refuzoj propozimet për ekspertë – edhe pse shumë shpesh

¹⁷ Për korrektësi, duhet theksuar se disa ekspertë kanë potencuar se janë të shumta rastet kur kërkesat e gjykatës janë të paqarta në lidhje me çështjen për të cilën kërkohet ekspertiza.

janë të njëjtit ekspertë ose që institucionet përkatëse dërgojnë vetëm disa përfaqësues të tyre në cilësinë e ekspertit.

Ne këtë drejtim, do të ishte e rrugës që, edhe pse ky është një aspekt procedural, që me ndryshimet e reja të vendosen edhe disa kriterë rreth shpeshësisë së ftesës së eksperteve pasi që eksperti është ekspert pavarësisht se kush është ai/ajo, dhe në këtë mënyrë i largohet perceptcionit se ka ndonjë aranzhim të fshehtë mes palëve dhe gjyqtarit.

Si praktike e mirë do të mund të mërej për bazë Marrëveshje e Mirëkuptimi mes KGJK dhe Odës së Avokateve e vitit 2014 ku është parandaluar thirrja e vetëm disa avokatëve me detyrë zyrtare dhe një aranzhim i ngjashme do të mund të parashihej edhe me ligj të ri ku palët do të propozonin ekspertizë, kurse gjykata do ta ftonte eksportin e fushës i cili është në radhë për t'u ftuar.

Institute publike që ofrojnë ekspertizë gjyqësore

Një tjetër çështje/problem tjetër që duhet adresuar në gjykata dhe prokurori është çështja e pagesave të ekspertizave kur ato kryhen nga institute publike. Gjykatat dhe prokuroritë i dërgojnë Instituteve të caktuar urdhrin për ekspertizë gjyqësore, dhe i njëjti kryhet po që pagesa nuk i shkon Institutit por individëve që e kanë kryer ekspertizën në emër të Institutit.

Ligji i Procedurës Kontestimore, neni 358 (4 dhe 5) përcakton se ekspertizat me të ndërlikuar i besohen në rend të parë institucioneve profesionale (spitaleve, laboratorëve kimike, fakulteteve etj) [...] dhe nëse ekzistojnë institucionet e specializuara për llojet e caktuara ekspertizash (ekspertiza e monedhave të falsifikuara, e dorëshkrimeve, mandej ekspertiza daktiloskopike etj), atëherë ekspertizat e tilla do t'u besohen institucioneve të tilla.

Po ashtu, i njëjti Ligj përcakton se (neni 358.3) ekspertet caktohen, në radhë të parë, nga radha e ekspertëve të përhershëm të emëruar nga gjykata për llojin e caktuar të ekspertimit. Kjo duhet të kihet parasysh gjatë adresimit të mëtutjeshëm të kësaj çështjeje pasi që ky Ligj në një farë mënyrë paracakton se ekspertët duhet "emëruar" nga Gjykata.

Kurse me Kodin e Procedurës Penale (neni 136) thuhet vetëm se eksperti duhet të ketë përvojë ose trajnim të specializuar që është relevant dhe aktual kurse sa i përket institucioneve publike Kodi i Procedurës Penale (neni 136) përcakton se:

5. Nëse eksperti në fjalë është i punësuar nga Qeveria e Kosovës në cilësinë e ekspertit të mjekësisë ligjore ose ekzaminuesit mjeko-ligjor, ai zbaton ekspertimin

e specializuar siç përcaktohet me ligj, me urdhër të gjykatës apo me urdhër të prokurorit të shtetit.

6. Nëse në institucionin profesional apo organet publike nuk ekziston ekspertiza përkatëse, eksperti me ekspertimin përkatës angazhohet dhe kompensohet nga fondet publike. Shpenzimet e ekspertit i shtohen shpenzimeve të procedurës.

Nga këto dy paragrafë rezulton se ekspertiza gjyqësorë në procedure penale fillimisht u besohet institucioneve publike të thirrura për të kryer ato ekspertiza. Dhe vetëm në rastet kur rezulton se në institucionin profesional apo organet publike nuk ekziston ekspertiza përkatëse, eksperti i jashtëm angazhohet dhe kompensohet nga fondet publike.

Një çështje tjetër që duhet potencuar në lidhje me pagesat e ekspertizave kur ato kryhen nga institute publike, është se përfaqësuesit e këtyre institucione kanë shpreh shqetësimin se çdo ndryshim radikal do të shpinte në deformim të sektorit publik me rrezikun që do të ndikonte në largimin e ekspertëve nga institucionet publike dhe përqendrimin e tyre në sektorin privat.

Unifikimi i kritereve

Problematikë tjetër është se disa akte që rregullojnë çështjet e ekspertëve nuk kërkojnë të njëjtat kritere, dhe të njëjtit mund të angazhohen si ekspertë gjyqësorë p.sh. ekspertët e prokurimit publik, ekspertët forenzikë të mashtrimit financiar, vlerësuesit e pronave, etj.

Vlerësuesit e pronave fillimisht janë trajnuar dhe certifikuar si të tillë nga Oda Ekonomike e Kosovës kurse tani janë integruar brenda sistemit shtetëror në kuadër të Ministrisë së Financave. Aktualisht, në listë janë 416 vlerësues të licencuar të pronës.¹⁸ Të njëjti kanë edhe Shoqatën e Vlerësuesve të Kosovës e regjistruar si OJQ.

Duhet theksuar se për tu licencuar si Vlerësues i Pronës nuk është kërkuar ndonjë përvojë paraprake por vetëm që të kenë diplomë universitare në njërin nga fakultetet në vijim: Ndërtimtari, Gjeodezi, Arkitekturë, Ekonomi, Bujqësi dhe Pylltari, drejtimi Matematikë dhe Juridik si dhe të kryejnë trajnimin përkatës të organizuar specifikisht për këtë qëllim.

Në anën tjetër, kemi edhe ekspertët forenzikë të mashtrimit financiar të certifikuar nga Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës të cilët kanë certifikuar 42 zyrtarë të policisë, prokurorisë, doganave, Administratës Tatimore, Njesisë për Inteligjencë Financiare, etj. Certifikimi i tyre është bërë pas një vitit të plotë akademik të arsimit dhe trajnimit praktik dhe pas vlerësimit të njohurive përmes provimit

¹⁸ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/EFA2B996-1DA1-43A6-896B-3826E8CEA771.pdf>

përfundimtar. Vetëm ata që kanë kaluar provimin përfundimtar me sukses janë certifikuar me titullin si ekspertët forenzikë të mashtrimit financiar.

Çështja këtu është se gjatë përpilimi të ligjit të ri duhet pasur parasysh dy gjera:

- i. A duhet njohur përvojën e gjertanishme si ekspertë gjyqësorë edhe këtyre personave dhe me automatizëm të ju njihet cilësia e ekspertit gjyqësor për shkak të trajnimeve të kryera specifike për fushë të caktuar, apo
- ii. si duhet bere unifikimi i kriterëve, pasi që vlerësuesit e pronave nuk u është kërkuar vite minimale përvoja punës kurse për eksperte tjerë kërkohet një minimum i caktuar i viteve përvoja për t'u konsideruar për t'u licencuar si ekspert.

Licencimi i personave juridikë

Çështje tjetër problematike që nuk është saktësuar me rregullativën aktuale në fuqi është edhe çështja e personit juridik. Derisa eksperti si person fizik duhet themeluar biznes individual (që në fakt është person juridik) çështja që duhet trajtuar është çështja e kompanive që mund të punësojnë ekspertë të lëmive të caktuara dhe të ofrojnë shërbime të ekspertizave. Siç e kemi vërejtur më lartë, shtetet në rajon kanë parapa mundësinë që edhe kompanitë private të mund të licencohen për të dhënë ekspertiza gjyqësorë me kushtin që ekspertët që i punëson të plotësojnë kushtet e parapara për ekspert gjyqësorë (individual).

Tarifat e ekspertëve

Një çështje tjetër që është shfaqur si problematike është lartësia e tarifave dhe caktimi i tyre. Ekspertët gjyqësor kanë cekur se për rastet më të komplikuar tarifat janë shumë të ulëta sidomos të rastet e vlerësimit të kontratave apo transaksioneve kur janë në pyetje hetimet për keqpërdorim ose për mashtrime financiare kurse shumat mbi të cilat bëhen ekspertiza janë shumë milioneshe. Kjo ndikon në atë që ekspertët e mirëfillte nuk pranojnë të marrin lëndë të tilla e si rrjedhojë përfundojnë në duar të ekspertëve që nuk kanë njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për të bërë një ekspertizë të tillë.

Për më tepër, tarifat e eksperteve duhet që të rregullohen jo në mënyrë të pavarur nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Më idealja do të ishte sikur këto tarifa të miratohen nga i) KGJK-ja por pas konsultimit me Ministrinë e Financave ose ii) nga vete Qeveria e Republikës së Kosovës.

Praktika të ndryshme nga Institucionet publike

Po ashtu, gjatë analizimi të situatës në terren është vërejtur se ka disa institucione që angazhojnë apo punësojnë individë që ofrojnë ekspertiza qoftë te njëhershme apo kanë të punësuar individë më kontratë të rregullte por që ose e kanë titullin e punës si ekspert ose ofrojnë opinione në formë të ekspertizave. Të tilla institucione janë disa përfshirë: Organin par Shqyrtimin e Prokurimit Publik, Prokuroria Speciale, Komunitat dhe se angazhimi i tyre si eksperte gjyqësore në të ardhmen duhet adresuar dhe rregulluar në atë mënyrë që ekspertiza e tyre të ketë fuqinë e provës në procedurë gjyqësore apo administrative apo që edhe mund të thirren si dëshmitar në seancë gjyqësore për të mbrojtur të gjeturat e ekspertizës së tyre.

Moskëzitim i trajnimeve të specializuara

Gjatë diskutimeve në Grup Punues, është potencuar se një ndër çështjet që duhet adresuar është edhe fusha e trajnimeve. Në Akademinë e Drejtësisë nuk ekzistojnë module të caktuara ku do të mund të merrnin trajnime si gjyqtarët dhe prokurorët po ashtu edhe ekspertët gjyqësore. Kjo për arsye se jo rrallë ka pasur kritika se i) ose ekspertiza nuk është konform kërkesave të caktuara nga gjyqtari apo prokurori ose ii) që gjyqtari apo prokurori nuk ka qenë i saktë në kërkesën e tyre. Këtu duhet shtuar edhe çështjet që janë ngritur nga Instituti për Psikiatri Forenzike¹⁹ të cilët kanë deklaruar se gjykatat dërgojnë pa përjashtim të gjitha rastet e dhunës në familje për mendim profesional tek Instituti.

Në këtë drejtim është potencuar si çështje edhe mos profilizimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve për lëmenj të caktuar të cilët do të ishin me efikas në çështjet e ekspertizave të caktuara gjyqësore.

¹⁹ Takim me menaxhmentin dhe stafin e Institutit të Psikiatri Forenzike, 24 maj 2021.

Kapitulli 2: Objektivat

Në radhë të parë, kjo politikë hyn në kuadër të qëllimit strategjik të Programit të Qeverisë 2021-25“ *Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative*”, përmes së cilës do të ketë angazhim në vazhdimësi për reformimin e drejtësisë penale, civile dhe administrative, që synojmë ta arrijmë nëpërmjet ndryshimit të politikave dhe kornizës ligjore përkatëse, rrjedhimisht dhe në këtë kuadër do të krijojmë bazë të veçantë ligjore edhe për fushën e ekspertëve gjyqësorë.

Strategjia për Sundim të Ligjit, konkretisht Plani i Veprimit (Kapitulli I (I.2)) parasheh si masë të veçantë hartimin e Koncept Dokumentit mbi Ekspertizën Gjyqësore dhe Prokuroriale.

Figure 3: Objektivat relevante të Qeverisë

Objektivi relevant	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
<i>Qëllimi strategjik –</i> Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025. Strategjia për Sundim të Ligjit
<i>Objektiva specifike –</i> Krijimi i mekanizimit unik për emërimin e ekspertëve Zhvillimi i rregullave dhe kriterëve për angazhimin e ekspertëve në procedura gjyqësore apo administrative	Sipas këtij Koncept Dokumenti.
<i>Qëllimi i politikës –</i> <i>Krijimi i bazës së veçantë ligjore për fushën e eksperteve gjyqësorë</i>	Sipas këtij Koncept Dokumenti.

Kapitulli 3: Opcionet

Kapitulli 3.1: Opcioni asnjë ndryshim

Opsioni asnjë ndryshim nënkupton që nuk do të merren kurrfarë masa zbatuese dhe as legislative për të adresuar problemet kryesore të shpjeguara më lartë. Me opsionin pa asnjë ndryshim do të vazhdonin të ekzistonin problemet kryesore lidhur me mungesën e legjislacionin adekuat për emërimin dhe rregullimin e fushës së ekspertëve gjyqësorë.

Siç është elaboruar më lartë në kuadër të kapitullit për problemin kryesor, ndonëse Kosova ka parapare që çështja e ekspertëve gjyqësorë t'i besohet Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nuk ka arritur që të zbatojë këtë pjesë të ligjit që ka qenë në mandatin e saj. Përveç hartimit të Rregullores për ekspertët gjyqësorë, KGJK nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim tjetër në funksion të emërimit të ekspertëve gjyqësorë.

Rregullorja në fjalë, përveç që ka përparësi të veta ka edhe disa dobësi:

- i) lejohet angazhimi i personave që nuk kanë diplomë fakulteti të kryer me kushte: për ata që kanë të përfunduar shkollën e lartë të kenë 5 vite përvojë pune, dhe për ata që kanë shkollën e mesme të kenë 10 vite përvojë pune, ose
- ii) te mënyra e aplikimit kërkohet që të gjithë ata që aplikojnë të kenë paraprakisht edhe përvojë pune të ekspertit.

Siç u përmend edhe më lartë, tarifat për ekspertë gjyqësorë duhet që të rregullohen jo në mënyrë të pavarur nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Kapitulli 3.2: Opcioni për ndryshimin dhe plotësimin e kornizës ekzistuese ligjore

Plotësim / Ndryshimi i Ligji aktual për Gjykata / Nxjerrja e një Rregulloreje të re nga KGJK në dritë të plotësim/ndryshimit të Ligjit.

Opsioni i dytë që mund të trajtohet është që në kuadër të Ligjit për Gjykata të shtohet një pjesë (kapitull i veçantë) i cili do të adresonte në mënyrë më adekuate kushtet për kryerjen e ekspertizës, procedurën e emërimit dhe shkarkimit të ekspertëve të gjykatës, procedurën e regjistrimit dhe fshirjes së personave juridikë që kryejnë ekspertizën, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Kjo do të vendoste një siguri më të lartë juridike, në raport me nivelin aktual që është e rregulluar kjo fushë dhe jo siç përcaktohet me Rregullore të KGJK-së – sepse mundësitë që të ndryshohen kriteret apo kërkesat tjera ligjore do të jenë minimale. Pra, derisa ky kapitull do të vendostë në rrafshin ligjvënës kriteret bazë, Rregullorja e KGJK do të ishte më shumë në funksion të “legjislacionit zbatues”.

Ligji për Gjykata do të duhej që në minimum të përcaktonte kriteret për licencimin e ekspertëve, dokumentacioni i nevojshëm për aplikim, subjektet që kryejnë ekspertizën, të drejtat dhe detyrimet e ekspertit gjyqësor, kushtet dhe mënyrën e kryerjes së ekspertizave, lëshimin, vazhdimin, përfundimin ose heqjen e licencës së ekspertit gjyqësor, mirëmbajtja e regjistrit të ekspertëve nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, tarifat e shpërblimit dhe rimbursimi i kostove për ekspertiza, betimin dhe vulën, etj, si dhe themelimi i Odës së Ekspertëve, nëse shihet si e domosdoshme.

Në këtë drejtim, Ligji për Gjykata në kapitull të veçantë do të rregullonte çështjet në vijim.

Kriteret

Kriteret për certifikim të ekspertëve sipas të cilave minimumi i kriterëve përfshirë vitet e përvojës së punës do të jenë:

1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
2. të ketë certifikatë mjekësorë që vërteton aftësitë e tij për të kryer detyrat e ekspertit
3. certifikatën e themelimit të biznesit individual, me numër fiskal,
4. të ketë njohuri profesionale dhe përvojë praktike në një fushë të caktuar të ekspertizës, si në vijim:
 - a. të paktën 5 vjet - pas përfundimi të studimeve master,
 - b. të paktën 7 vjet - pas përfundimi të studimeve themelore (bachelor me 240 ECTS),
 - c. të paktën 9 vjet - nëse ai/ ajo ka përfunduar shkollën e mesme, e që nuk ka mjaftueshëm eksperte me diploma universitare (p.sh. ekspertë të kriptovalutave, ekspert të kibernetikës apo kontabilistë forenzikë por që kanë dëshmi për përfundimin me sukses të trajnimeve të akredituar për fushë përkatëse.

Me këtë plotësim / ndryshim të Ligjit do duhej siguruar që të eliminohet mundësia që personat pa diplomë universitare të angazhohen si ekspertë gjyqësorë vetëm në raste tejet të jashtëzakonshme dhe për fusha jo tipike.

Institucionet publike / persona juridikë

Ligji për Gjykata duhet të parashoh që ekspertizat ne parim te ofrohen nga institucionet publike, dhe vetëm në rast se institucionet publike nuk mund të ofrojnë ekspritzën e caktuar, atëherë ekspertiza do te kërkohet në sektorin privat. Në këtë drejtim, Ligji duhet te parasheh edhe mundësinë që personi juridik mund të certifikohet si biznes që mund të ofrojë shërbime për dhënie te ekspertizave.

Autoritet emërues

Kryetari i Gjykatës Themelore do të ishte autoriteti që do të zhvillojë dhe administrojë procedurat për emërimin e ekspertëve gjyqësorë dhe se vendimi përfundimtar mbi emërimin / shkarkimin e ekspertit do të merrej nga Kryetari i Gjykatës Themelore pas rekomandimit të dhënë nga Komisioni i veçantë i themeluar për këtë qëllim. Në sajë të kësaj, eksperti do të ishte kompetent vetëm për territorin që e mbulon juridiksioni territorial i Gjykatës nga e cila e merr vendimin për emërim.

Lista e ekspertëve

Listat e ekspertëve do te publikohej edhe ueb faqen e gjykatave për ekspertë qe mbulojnë territorin e asaj gjykate, kurse lista e konsoliduar e te gjithë eksperteve te emëruar ne territorin e Republikës e do te publikohej ne ueb faqen e KGJK-së.

Rregullorja për zbatimin e neneve për ekspertët gjyqësor do të duhej të nxirrej nga Këshill Gjyqësor i Kosovës, në koordinim me Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe do duhet të rregulloj vetëm aspektin procedural në raport më kandidatet për ekspertë gjyqësorë. Pra, ky akt nënligjor do duhej të rregulloje aspektin e thirrjes për ekspertë, mënyrën e aplikimit, dokumentacioni i nevojshëm për aplikim, lëshimi i kartelës identifikuese, procedurat standarde të veprimit për regjistrim, ndryshim dhe fshirjeje nga regjistri i ekspertëve, dhe çështje tjera të bazuara në Ligjin për Gjykata.

Njëkohësisht rekomandohet që për secilin profesion për kualifikimet paraprake që mund të pranohen para se të licencohen ekspertët, të kontaktohen odat, respektivisht shoqatat profesionale dhe fillimisht të njihen certifikimet profesionale p.sh për ekspert financiar të njihet certifikata e kontabilistit të certifikuar etj.

Pra siç shihet nga paragrafët e mësipërm minimumi i kërkesave ligjore që duhej të parashihen në Ligjin për Gjykata, veçse e tejkalojnë në aspektin organik materien që duhej trajtuar Ligji për Gjykata. Po ashtu, ekspertët gjyqësorë duhet të jene te pavarur dhe nëse aktualisht me Ligj kërkohet që këta të emërohen nga KGJK, së paku në aspektin e perceptimit publik, nuk sigurohet pavarësia e plote pasi që KGJK rekruton gjyqtarë dhe administron gjykatat ashtu edhe ekspertet të cilët duhet të bëjnë ekspertiza edhe për prokurorinë që është pale ne procedure mund të jetë pak më jo objektivë duke qene se i nënshtrohen procesit eventual disiplinor nga KGJK.

Në anën tjetër, duhet theksuar se ky opsion nuk i lejon shume hapësirë MD-së që të përfshihet në procesin e emërimit të ekspertëve gjyqësorë pasi që do të ishte inorganike që përmes Ligjit për Gjykata, MD-ja të mvishet me kompetenca për ekspertë gjyqësorë.

Kapitulli 3.3: Nxjerrja e një ligji të ri për emërimin e ekspertëve gjyqësorë.

Opsioni i tretë, dhe i rekomanduari, është që MD-ja të iniciojë nxjerrjen e një Ligji të ri për ekspertët gjyqësorë.

Në këtë drejtim, Ligji i ri i cili do të nxirrej do të unifikojë shumë çështje problematike që ka nxjerrë shtjellimi i objektit që ka trajtuar ky Koncept Dokument.

Megenëse ideja e një ligji të ri është që ekspertizat e ekspertëve të licencuar do të përdreshin edhe për procedura tjera, jo vetëm gjyqësore, pra edhe nga organet tjera administrative në rast nevojë, fushëveprimi i këtij ligji zgjerohet dukshëm e si rrjedhojë edhe emërtimi i Ligjit do të duhej të ishte me i përgjithshëm, për dallim nga Ligji për Ekspertë Gjyqësorë apo Ekspertiza Gjyqësorë, po në mënyrë që të nënkuptojë edhe ekspertiza për institucione tjera.

Si alternativa kanë mbetur Ligji për Ekspertët ose Ligji për Emërimin e Ekspertëve.

Më një fushëveprim të ri të Ligjit, ekspertët e angazhuar nga prokuroria dhe gjykata, por jo vetëm, edhe ata të punësuar ose angazhuar nga OSHP, AKP, PSRK, si dhe institucione tjera qoftë me kontratë të përhershme ose jo, do të duhej të i nënshtrohen certifikimit siç do jetë e përcaktuar me ligj të ri.

Në këtë drejtim Ligji do të bëj diferencimin ndërmjet institucioneve publike që ofrojnë ekspertiza dhe të cilët nuk do të i nënshtrohen procesit të emërimit. Përgjashtimisht, kur personat e punësuar në këto institucione dëshirojnë të ofrojnë shërbime (ekspertiza) në

cilësi private si individë, jashtë institucionit publik, në këto raste duhet të i nënshtrohet procesit të emërimit si ekspert.

Kjo shpie edhe në kategorizimin e ekspertëve në ekspertë publikë (të punësuar dhe paguar nga sektori publik) dhe në ekspertë të sektorit privat.

Ekspertët publikë

Institucionet publike që ofrojnë shërbime të ekspertizave për gjykatat dhe organet tjera shtetërore do të i'u njihet titulli i ekspertit përderisa janë të punësuar në institucion publik përkatës. Në këto rrethana, çdo ekspertizë që kërkohet të jepet nga institucioni publik do të jetë e bërë në kuadër të punës që kryen, përjashtimisht kompensimin për rrugën apo shpenzime tjera të ngjashme.

MD-ja do të publikojë listën e gjitha organeve publike që ofrojnë ekspertizë dhe fushën të cilën ato organe publike e mbulojnë. Duhet cekur, se me ligj duhet paraparë që pagesa për shërbim do të i bëhet organit publik, derisa individët e angazhuar mund të marrin ndonjë bonus për angazhimin e tyre në dhënien e ekspertizës, megjithëqë totali i atij bonusi nuk guxon të kalojë shkallën 25% të pagës bazë që individë ka të parapara më kontratë pune me organin publik (p.sh mjeku në SHSKUK përjashtimisht Institutit për Psikiatri Forenzike, eksperti i Urbanizmit në Komune apo profesor i Fakultetit Teknik).

Ky rregull për bonus nuk do të vlejë për organet publike që me ligj ose akt tjetër normativ janë të autorizuar të ofrojnë ekspertizë, pasi që ato mbulohen me pagat bazë. Në këtë drejtim, gjatë rregullimit të çështjes së pagesave duhet marrë për bazë edhe zgjedhjet juridike që do të vendosen në Ligjin e ardhshëm për pagat.²⁰

Ekspertët privatë Autoriteti kompetent që do të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të certifikimit të ekspertëve do të jetë MD-ja, që nënkupton se kompetencat themelore dhe autoritetin përfundimtar për të regjistruar/certifikuar një person si ekspert ose edhe për ta hequr atë nga lista do të jenë të MD-së. Megjithatë, MD-ja në Komisionet përkatëse për certifikimin dhe largimin e eksperteve të angazhuar edhe përfaqësues nga KGJK-ja dhe KPK-ja në mënyrë që ky proces të jetë me gjithëpërfshirës edhe për faktin se këto dy institucione janë organe që marrin më së shumti shërbime nga ekspertët. Si rrjedhojë,

²⁰ Duke qenë se ky Koncept Dokumenti (fq. 32) ka vënë në pah shqetësimin e personelit të punësuar në institucione publike, Ministria e Drejtësisë, në koordinim me ministrinë e linjës do të duhej që të angazhoheshin në caktimin e një niveli më dinjitoz të pagave dhe që në afat të mesëm (5-7 vitet e ardhme) të ngritin resurset dhe kapacitetin në këto institucione.

edhe registri i ekspertëve do të mirëmbahet nga MD dhe do të jetë gjerësisht i qasshëm nga publiku përmes publikimit dhe azhurnimit në ueb faqen zyrtare të MD-së.

Kriteret për certifikim të ekspertëve do të jenë të përshkallëzuara por që i mbetet Grupit Punues përgjatë hartimit të ligjit që këtë përshkallëzim ta disenjojë përshtatshmërisht me kontekstin vendor. Megjithatë minimumi i kriterëve përfshirë vitet e përvojës së punës duhet që aplikuesi:

1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
2. të ketë certifikatë mjekësorë që vërteton aftësitë e tij për të kryer detyrat e ekspertit
3. certifikatën e themelimit të biznesit individual, me numër fiskal,
4. të ketë njohuri profesionale dhe përvojë praktike në një fushë të caktuar të ekspertizës, si në vijim:
 - a. të paktën 5 vjet - pas përfundimi të studimeve master,
 - b. të paktën 7 vjet - pas përfundimi të studimeve themelore (bachelor me 240 ECTS),
 - c. të paktën 9 vjet - nëse ajo ka përfunduar shkollën e mesme , e që nuk ka mjaftueshëm eksperte me diploma universitare (p.sh. ekspertë të krypto valutave, ekspert të kibernetikës apo kontabilistë forenzikë por që kanë dëshmi për përfundimin me sukses të trajnimeve të akredituar për fushë përkatëse.

Përvoja e punës duhet dëshmuar përmes pagesave të bëra në Trustin Pensional të Kosovës. Po ashtu, përvoja e punës duhet të jetë e njëjte me fushë veprimtarinë për të cilën personi aplikon për t'u certifikuar si ekspertë. Përfundimisht, ky rregull sa i përket fushe veprimtarisë nuk do vlejë për kategorinë "c" të cekur më lartë si edhe për specialistët mjekësorë të cilët kushtin për vitet e punës do ta fitojnë më përfundimin e provimit specialistik.

Njohuritë e aplikantëve dëshmohen nga kandidati përmes publikimeve ose punimeve shkencore, përfundimi me suksese të trajnimeve të organizuara nga shoqatat profesionale, si dhe opinione të dhëna për gjykatat ose organet e tjera shtetërore, shoqatat profesionale, institucionet shkencore dhe institucionet e tjera ose personat juridikë për të cilët kandidati ka punuar, gjegjësisht për të cilën ka kryer punë profesionale.

Një trajtim të veçantë duhet të ketë edhe e kaluara kriminale e aplikuesëve. Rekomandohet që MD-ja para së të bëjë shqyrtimin e dokumentacionit të kërkojë nga KGJK-ja të dhëna në lidhje me informatat e aplikuesëve rreth së kaluarës së tyre kriminale. Do të ishte e udhëzueshme që kjo norme të përfshijë të gjitha veprat penale dënimet e të cilave janë në evidencën penale (pra nuk janë të fshira qoftë sipas fuqisë

ligjore qoftë sipas vendimit gjyqësor). Nga ky rregull do të përjashtoheshin kryesit e veprave penale të cilët janë dënuar për kryerjen e veprës penale nga pakujdesia dhe për të cilën është dënuar deri në një (1) vit burgim efektiv.

Sa i përket personave juridikë, duke mos përfshirë këtu bizneset individuale, kushtet që duhet plotësuar janë të enë të regjistruara në ARBK si shoqëri biznesi dhe në kuadër të veprimtarisë së tyre kanë edhe kryerjen e ekspertizës për një fushë të caktuar si dhe nëse së paku tre (3) punonjës. Të asaj shoqatë biznesi i plotësojnë kushtet e parapara për ekspertë individual, duke përjashtuar këtu kërkesën për themelimin të biznesit individual.

Procedura e certifikimit do të jetë e administruar nga MD-ja, dhe certifikimi dhe regjistrimi i ekspertëve në liste do të bëhet përmes shikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikantët. Vendimi për certifikim do të nënshkruhet nga Ministri i Drejtësisë pas rekomandimit të dhënë nga Komisioni përkatës të cilin e themelon Ministri i Drejtësisë. Siç u cek edhe më lartë, përkitazi me përbërjen e Komisionit, i njëjti do të përbehet përveç nga përfaqësuesit e gjyqësorit dhe prokurorisë edhe nga profesionistët e fushave përkatëse për të cilën MD-ja ka bërë thirrje publike për ekspertë. Për më tepër, për ato profesione që janë të rregulluar përmes odave përkatëse do të duhej që në përbërje të këtij Komisioni të jenë edhe përfaqësuesit e odave.

I njëjti parim sa i përket përbërjes do të vlejë edhe për komisionin disiplinor. Ministri do të merr vendim për largim nga regjistri i eksperteve vetëm në rastet kur ka një rekomandim të tillë të bërë nga kryetari i gjykatës, kryeprokurori i prokurorisë ose nga ndonjë udhëheqës i institucionit në rastet se ka dëshmi se ekspertiza është bërë në mënyrë jo profesionale, është e anshme ose *mala fides*.

Mandati i ekspertëve do të jete i kufizuar, në afat pesë (5) vjeçar dhe mund të ripërtërihet me automatizëm me një **kërkesë të arsyetuar** bërë MD-së. MD-ja do të bëjë lëshimin e kartelave identifikuese të të gjithë eksperteve me një numër unik.

Po ashtu, MD-ja përmes njësive të saja përkatëse do të bëjë edhe menaxhimin e thirrjes së eksperteve në procedura. Edhe pse legjislacioni aktual i lejon që palët të bëjnë përzgjedhjen, Ligji i ri, në mënyrë që të mënjanojë çfarëdo favorizimi nga avokatët, prokurorët, gjykatat apo palët tjera, do të bëjë angazhimin e ekspertëve në fusha të caktuara sipas renditjes së angazhimit dhe sipas ndarjes gjeografike.

Sa i përket ndarjes gjeografike, ekspertët në parim do të kenë kompetencë territoriale për të dhënë ekspertiza në tërë territorin e Republikës, megjithatë për ato fusha ku ka më shumë ekspertë në fushë të caktuar do të bëhet ndarja regjionale, sipas vendbanimit/selisë së ekspertëve, në mënyrë që të evitohet angazhimi i ekspertëve nga

qendrat tjera regjionale me qellim te ekonomizmit të ekspertizës, sigurimit te një efikasiteti me ta larte dhe shpërndarjes me proporcionale te ekspertëve te regjistruar.

Ligji i ri duhet te përmbajë edhe një kapitull ku duhet te përcaktohen te drejtat dhe detyrimet e ekspertëve si dhe nxjerrjen e Kodit Etik nga ana MD-së të cilët duhet të i përmbahen të gjithë ekspertët, sidomos ne drite të faktit se ka shumë seanca gjyqësorë që dështojnë për shkak të mungesë së paparalajmëruar te ekspertëve.

Të drejtat dhe detyrimet e ekspertëve do të jenë të bazuara mbi përcaktimet e gjetura në Udhëzuesi për rolin e ekspertëve të caktuar nga gjykata në procedurat gjyqësore të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës.

Për më tepër, Ligji i ri duhet të përmbaje edhe disa nene ku vendosen parametra e tarifimit për eksperte ose që të krijohet baza ligjore që tarifatat të i nxjerrë përmes një vendimi ose MD-ja ne bashkëpunim me MF-se ose që për këtë të autorizohet Qeveria e Kosovës.

Për fund, Ligji i ri duhet të potencojë se gjitha ligjet tjera që nuk janë në përputhshmëri me këtë ligj do te interpretohen asisoji qe kërkesat e parapara me ketë ligj do te mbizotërojnë.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Në kuadër të këtij kapitulli paraqiten ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar lidhur me opsionet e analizuara në këtë Koncept Dokument.

Ndërkaq, shtojcat 1 deri 4 paraqesin vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve të drejtave themelore. Këto mjete janë të listuara në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Katër shtojcat gjithashtu tregojnë vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës.

Në tabelën e mëposhtme listohen ndikimet më të rëndësishme të identifikuara të opsionit të parë.

Figura 7: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit për opsionin 1

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
	Opsioni 1 dhe 2
Ndikimet ekonomike	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet shoqërore	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet në të drejtat themelore	- Neni 31 E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm <i>Me këtë Opsion, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është cenuar në mënyrë aktive deri më tash për shkak të dështimi të organit përgjigjes të licencojë individët të cilët realisht do të kishin plotësuar kushtet për t/u cilësuar si ekspert gjyqësor</i>
Ndikimi gjinor	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.
Ndikimet e barazisë sociale	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.
Ndikimet tek të rinjtë	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.
Ndikimi i NMV-ve	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
	Opsioni 3
Ndikimet ekonomike	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet shoqërore	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta
Ndikimet në të drejtat themelore	- Neni 31 E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm <i>Me këtë Opsion, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm do të jete me efektivsiht e zbatuar pasi që do të vendoseshin rregullat për ekspertiza që jepen si nge sektori publik po ashtu edhe nga ai privat.</i>
Ndikimi gjinor	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.

Ndikimet e barazisë sociale	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.
Ndikimet tek të rinjtë	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.
Ndikimi i NMV-ve	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.

Ndikimet më të rëndësishme që mund të shfaqen nëse vendoset, për adresimin e problemit të evidentuar në këtë Koncept Dokument, përmes ndryshimeve ligjore do të trajtohen në kuadër të tabelës vijuese. Ky elaborim do vlejë njëkohësisht për opsionin 2 dhe 3.

Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Gjatë hartimit të Koncept Dokumentit nuk janë paraqitur sfida të theksuara në mbledhjen e të dhënave. Kjo thënë, ndonëse, hartimi i këtij Koncept Dokumenti është bërë gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, si pasojë e së cilës edhe takimet në përbërje të plotë të grupit punues kanë qenë më të limituara. Në këtë drejtim, informatat e nevojshme për zhvillimin e analizës dhe hartimin e këtij Koncept Dokumenti janë siguruar përmes takimeve të drejtpërdrejta me akterët relevantë si dhe marrjes së informacioneve përmes pyetjeve të marra nga pyetësi i zhvilluar enkas për këtë koncept dokument.

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Në këtë kapitull është paraqitur plani i aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit për këtë Koncept Dokument. Pjesa më e madhe, e palëve të brendshme të interesuara (ato të paraqitura në Figurën 4 nga Kapitulli mbi Përkufizimin e Problemit), janë pjesë e grupit punues dhe kanë hartuar apo janë konsultuar gjatë hartimit të dokumentit. Sa i përket publikut, gjithashtu janë planifikuar aktivitete në këtë drejtim, të përcaktuara në tabelën e mëposhtme, në mënyrë që kjo politikë, e cila është e natyrës së re në Kosovë, të komunikohet dhe konsultohet në mënyrë të duhur deri në finalizimin e saj.

Konsultimi paraprak sipas Rregullores së Punës së Qeverisë do të realizohet pas përfundimit të punës së grupit punues në draftin fillestar.

Figura 9: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument

Procesi i konsultimit synon: - Marrjen e opinionit nga palët e interesuara lidhur me politikën e re në aspekt të përgjithshëm, si dhe me masat specifike dhe elementet tjera të saj në veçanti (për më shumë shihni Kapitullin 3 të këtij Dokumenti – Opsionet).						
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati indikativ	Buxheti i nevojshëm	Personi përgjegjës
Konsultimi i institucioneve relevante	KGJK, KPK, IML, IPF, ZKM MF,	Takime direkte me secilën palë veç e veç dhe përfshirja në grup punues		Nga fillimi i themelimit të grupit punues dhe deri në përfundim të këtij Koncept Dokumenti		Udhëheqësi i grupit punues dhe eksperti nga UNDP që ka ndihmuar në hartimin e këtij KD
Takimi i hapur për të gjithë palët e interesuara	KGJK, KPK, IML, IPF, ZKM MF	Takime direkte me secilën palë veç e veç dhe përfshirja në grup punues		Nga fillimi i themelimit të grupit punues dhe deri në përfundim të këtij Koncept Dokumenti		Udhëheqësi i grupit punues dhe eksperti nga UNDP që ka ndihmuar në hartimin e këtij KD
Konsultimi i palëve të jashtme të interesuara	Organizatave shoqërisë civile, organizatat e huaja që ndërlidhen me këtë politike	Konsultimi i draft Koncept Dokumentit me shkrim përmes platformës online/konsultimi me shkrim		28 dhjetor 2021 -20 janar 2022		Udhëheqësi i grupit punues përmes e-mailit ka pranuar komentet nga palët e interesuara

Kapitulli 6: Krahاسimi i opsioneve

Për adresimin e problemit të parashtruar në këtë Koncept Dokument, tre opsione janë marrë në konsideratë: opsioni pa asnjë ndryshim, opsioni për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatat, dhe opsioni për miratimin e një ligji të veçantë për trajtimin e çështjeve në lidhje me ekspertët gjyqësorë. Meqenëse të tre këto opsione janë trajtuar hollësisht në kapitullin 3, kjo pjesë e Koncept Dokumentit do të fokusohet shkurtimisht në krahasimin e tyre duke marrë për bazë përparësitë dhe disavantazhet e tyre dhe duke u mbështetur në analizën shumë kriterëshe.

Opsioni 1 i cili nuk propozon ndërmarrjen e ndonjë ndryshimi, por në vend të kësaj parasheh ruajtjen e *status quo*, nuk ngërthen në vete ndonjë përfitim.

Opsioni 2, parasheh që mekanizmi për emërimin e ekspertëve të mbetet ende tek KGJK-ja me disa ndryshime që me procesin e plotësim – ndryshimit të Ligjit për Gjykata, kriteret për emërim dhe disiplinim të jenë të vendosur si kategori ligjore.

Në këtë drejtim, ky Opsion do të kishte disavantazhe ligjore dhe operacionale. Disavantazhet ligjore kanë të bëjnë me atë se ekspertet e emëruar nga KGJK nuk do të mund të merreshin me ofrimin e ekspertizave për organet tjera administrative (nëse synohet kufizimi i qarte i pavarësisë institucionale) si dhe në anën tjetër MD-ja/Qeveria nuk do të mund të nxjerrtë akte nënligjore ose të lëshonte vendime implementuese të këtij ligji siç janë tarifatat, mirëmbajtja e listës, etj siç është në të gjitha shtete ne rajon. Për me tepër, asnjë shtet ne rajon nuk e ka të caktuar Këshillin gjyqësor si autoritet emërues i eksperteve gjyqësorë.

Kurse, disavantazhi operacional ka të bëjë me faktin se KGJK-ja ka dështuar në zbatimin e ligjit për sa i përket emërimit të ekspertëve gjyqësorë që nga viti 2015. Duke qene se nuk ka ndonjë mekanizëm llogaridhënës të drejtpërdrejt ne raport me Kuvendin kur KGJK nuk zbaton ndonjë ligj, edhe ne të ardhmen nuk do të merret ndonjë garanci se KGJK-ja do të zbatojë këtë ligj.

Kurse, Opsioni 3 përmbush gjitha ato që u ceken si disavantazhe nga dy opsionet me larte. Për me tepër, me Ligjin e ri për Ekspertet do të vendosen mekanizma të kontrollit edhe për sa i përket agjencive që janë nën menaxhim të degës ekzekutive ne raport me ekspertizat që japin për gjykata. Për me tepër, do të mund të vendoset edhe një rregull sa i përket marrjes së shërbimeve të ekspertizave jo vetëm nga gjykatat por edhe nga organet tjera administrative.

Kapitulli 6.1: Plani i zbatimit për opsionet e ndryshme

Në vazhdim është paraqitur plani i zbatimit për opsionin 3 të propozuar nga ky Koncept Dokument.

Figura 1: Plani i zbatimit për Opsionin 3

Qëllimi i politikës	Krijimi i bazës së veçantë ligjore për fushën e ekspertëve gjyqësorë							Shifra e kostos së pritur	
Objektivi strategjik	Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative								
	Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës								
Objektivi Specifik 1 Zhvillimi i rregullave dhe kriterëve për angazhimin e ekspertëve në procedura gjyqësore apo administrative	Outputi 1.1 Zgjerimi i mandatit të Departamentit për Profesione të lira në Ministrinë e Drejtësisë	Përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore							
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
		Aktiviteti 1.1.1 Hartimi i Ligjit për ekspertët gjyqësorë	X					MD	Nuk ka kosto shtesë
	Outputi 1.2								
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departame	

								nti përgjegjës	
		Aktiviteti 1.2.1 Nxjerrja e akteve nënligjor lidhur me procesin e emërimit dhe tarifat e ekspertëve gjyqësorë		x				Departamen ti për Profesionet e Lira, MD, Qeveria	
	Outputi 1.3 Zhvillimi i proceseve për emërimin e ekspertëve	Aktiviteti 1.3.1 Shpallja e ftesës për emërimin si eksperte nga ana e MD		x	x	x		MD	Nuk ka kosto shtesë
		Aktiviteti 1.3.2 Organizmi dhe zhvillimi i procesit të emërimit të						MD	
		Aktiviteti 1.3.3 Krijimi, bërja publike dhe azhurnimi i listës së ekspertëve		x	x	x		MD	

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Në bazë të këtyre që u theksuan më lartë, grupi punues është i mendimit që Opsioni 3 i paraqitur në këtë Kapitullin 3 të këtij Koncept Dokumenti është opsioni më i përshtatshëm nga shumë aspekte, për arritjen e objektivave të Qeverisë. Kështu që, Qeverisë së Republikës së Kosovës i propozohet miratimi i këtij Koncept Dokumenti me Opsionin 3 të rekomanduar, gjegjësisht hartimin e Ligjit të ri për Ekspertet që do të vendoste mekanizma të emërimit dhe disiplinimit të eksperteve, shërbimet e të cilëve do të shfrytëzoheshin përveç gjykatave dhe prokurorive edhe nga administrata publike. Po ashtu me ligj të ri do të mundësohej administrim më i mirë sa i përket agjencive që janë nën menaxhim të degës ekzekutive në raport me ekspertizat që japin për gjykata.

Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

Zbatimi i aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit por edhe i këtij lidhi në përgjithësi, do të monitorohen nga Ministria e Drejtësisë. Në vitin 2025 është paraparë të përgatitet një raport ex-post, i cili do të pasqyroj të gjeturat nga zbatimi dhe informoj politikë-bërjen e ardhshme në këtë fushë.

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës ²¹	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		X			
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		X			
Bërja e biznesit	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		X			
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		X			
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		X			
	A do të detyrohen bizneset të mbyllen?		X			
	A do të krijohen biznese të reja?		X			
Ngarkesa administrative	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja?		X			

²¹ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset?		X			
Tregtia	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		X			
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?		X			
Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?		X			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?		X			
Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?		X			
	A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		X			
	A do të rriten investimet nga diaspora?		X			
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		X			
	A do të rriten investimet e huaja direkte?		x			
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		x			
Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?		x			

	A do të ulet çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?		x			
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?		x			
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		x			
Ndikimi në NVM	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?		x			
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		x			
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		x			
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?		x			
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		x			
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?		x			
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		x			

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës ²²	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?		x			
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?		x			
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		x			
Ndikimet shoqërore rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		x			
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?		x			
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?		x			
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		x			
	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?		x			

²² Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

Përfshirja sociale	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		x			
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		x			
	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?		x			
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		x			
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?		x			
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?		x			
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?		x			
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?		x			
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?		x			
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		x			
Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?		x			
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		x			
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?		x			

	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?		x			
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?		x			
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	x				
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?	x				
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?		x			
	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?		x			
Shëndeti dhe siguria publike ²³	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?		x			
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?		x			
	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?		x			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?		x			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?		x			

²³ Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?		x			
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		x			
	A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?		x			
Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?		x			
	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?		x			
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?		x			
	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?		x			
	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?		x			

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)?		x			
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?		x			
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?		x			
	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?		x			
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		x			
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		x			
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		x			
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		x			
Cilësia e tokës dhe	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin,		x			

shfrytëzimi i tokës	ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?					
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?		x			
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?		x			
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?		x			
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të krijuara?		x			
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?		x			
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?		x			
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?		x			
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?		x			
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?		x			

KONCEPT DOKUMENTI PËR EKSPERTËT GJYQESORË

	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?		x			
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		x			
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?		x			
	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?		x			
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		x			
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		x			
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		x			
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		x			

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?		x			
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?		x			
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?		x			
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?		x			
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?		x			
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?	x		U	L	
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?		x			

	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?		x	U	L	
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		x			
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?		x			
Trajtimi i barabartë ²⁴	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	x				
	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinionimi politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)?		x			
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?		x			
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?		x			
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuar?		x			
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?		x			

²⁴ Barazia gjinore trajtohet në *Vlerësimin e Ndikimit Gjinator*.

KONCEPT DOKUMENTI PËR EKSPERTËT GJYQESORË

	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?		x			
	A ndikohet qasja në drejtësi?	x		U	L	L

